

BIBLIOTEKA

8 JF-31  
1974

# MAIL KADARE

## Vajza e Agamemnonit



roman

ZSH-1  
K 14

ISMAIL KADARE

# Vajza e Agamemnonit

Roman



Shtëpia Botuese "55"

## Parathënie

Më 1986, gjatë një prej udhëtimeve të tij në Paris, Ismail Kadare më tregoi në mirëbesim se dëshironte të depozitonte në një vend të sigurtë në Francë disa dorëshkrime, botimi i të cilave në Shqipëri, ishte në atë kohë, i pamundur. Ishte fjala për dy romane të shkurtër, një tregim dhe disa vjersha.

Autori kishte sjellë me vete një pjesë të këtyre teksteve. Duke qenë se nxjerra e dorëshkrimeve origjinale ishte rreptësisht e ndaluar nga ligjet shqiptare, Kadareja i kishte ndryshuar disi këto fletë, në mënyrë që të merreshin për përkthime nga një autor perëndimor. Për këtë qëllim, emrat e personazheve dhe të dekorit ishin zëvendësuar në tekst me personazhe dhe mjedise gjermane, ose austriake. Përsa i përket autorit të përkthyer, Ismail Kadare kishte zgjedhur romancierin

gjermano-perëndimor, Siegfried Lenz, disi i njohur në Shqipëri, por jo deri në atë shkallë, sa të dihej nëse ekzistonte ose jo, një roman i tij i titulluar “Tre K.”, siç quhej në atë kohë romani që u botua më pas me titullin “Hija”.

Kohë më pas, Ismail Kadare mundi të nxjerrë disa fletë të tjera të veprave në fjalë, por që ishin gjithmonë tepër pak për një rrezikim aq të madh. Me qëllim që të nxirrej pjesa tjetër, ne menduam se mënyra më e përshtatshme do të ishte, që unë vetë të udhëtoja për në Tiranë. Duke shfrytëzuar dy udhëtime të njëpasnjëshme, arrita të sjell në Paris pjesët e mbeturat dhe të plotësoja kështu, dorëshkrimet e “Hijes”, të “Vajzës së Agamemnonit”, të “Ikjes së shtërgut” dhe të vjershave.

Këto dorëshkrime u vendosën në Paris në “Banque de la Cité”. Në marrëveshje me Bankën, Ismail Kadare më dorëzoi çelësin e kasafortës së vet, bashkë me autorizimin që do ta hapja atë, në çastin që do ta quaaja të domosdoshme.

Në atë kohë, ashtu si dhe të tjerët, Ismail Kadare nuk besonte se do të shihte ditën kur komunizmi do të shembej në Shqipëri. Ky depozitim i dorëshkrimeve të rrezikshme, do t'i lejonte botuesit të tij që, në rast vdekjeje natyrale, ose “aksidentale” të shkrimitarit, të deklaronte aty

për aty, që një pjesë e veprës së tij, ende e panjohur, do të botohej shumë shpejt. Duke shpjeguar qysh më parë përmrbajtjen e këtyre dorëshkrimeve të panjohura, do të bëhej e mundur që të neutralizoheshin shtrembërimet e mundshme, që propaganda komuniste do të përpinqej t'i bënte veprës dhe imazhit të shkrimtarit.

Në të tre veprat në prozë, si dhe në vjershat e depozituara në Francë, shprehet në mënyrë direkte dhe pa ambiguitet, ajo që Ismail Kadare mendonte për regjimin shqiptar, mendime që ai i kishte trajtuar gjer atëherë në mënyrë indirekte dhe me aluzione, në romane si “Pallati i Ëndrrave”, “Kamarja e turpit”, “Koncert në fund të dimrit”, etj.

Nga këto dorëshkrime të emigruara në Francë, i pari që u botua ishte “Hija”, më 1994. Dorëshkrimit iu bënë prej autorit retushet e domosdoshme, për të fshirë tisin gjermanik, me të cilin ai ishte pudrosur, sidomos në pjesën e tij të parë.

Gjithashtu, u plotësuan aty-këtu zbrazëtitë artistike të lëna me vetëdije, përderisa qëllimi i veprës, në radhë të parë, ishte të kalonte, ose në një kuptim më të mirëfilltë, të kapërcente një mesazh përtej kufirit.

“Ikja e shtërgut” doli nga shtypi më pas. Në gjuhën shqipe, ai u botua njëkohësisht në dy

versione: në atë origjinal, ashtu siç kishte dalë nga Shqipëria, dhe në një version të dytë, i rishikuar artistikisht, prej të cilit u bë përkthimi frëngjisht.

“Vajza e Agamemnonit”, dorëshkrimi i tretë i depozituar në Francë, botohet tani, sipas dorëshkrimit të vitit 1985, pa më të voglin ndryshim. Ai përbën pjesën e parë të një diptiku, libri i dytë i të cilit, “Pasardhësi”, u shkrua në vitet 2002-2003. Këto dy romane, jo vetëm shtjellojnë të njëjtat personazhe, por përbëjnë një nga ansamblet letrare më të përkryera të Ismail Kadaresë.

CLAUDE DURAND  
President i “Editions Fayard”

Vajza e Agamemnonit

# 1

Që jashtë, nga rruga, vinte muzika festive, zallahia dhe zhurma e mbytur e hapave të kalimtarëve. Ajo zhurmë e veçantë, që mund të sajohet vetëm prej turmave që shkojnë të mblidhen në vendin e caktuar për parakalim.

Për të dhjetën herë mënjanova fare pak perden e dritäres, për të parë të njëjtën pamje: shtyrjen e ngathët drejt qendrës së qytetit të rrjedhës njerëzore. Sipër saj, njëloj si vitin e kaluar, ishin pankartat e buqetat e luleve dhe portretet e anëtarëve të Byrosë Politike. Fytyrat e tyre ngjanin edhe më të ngrira, mbi atë lumë kokash e duarsh. Herë-herë, për shkak të lëvizjes së duarve të portretmbajtësve, fytyrat e piktuvara dukej sikur vështroheshin anash, vëngër. Por edhe kur ato gjendeshin përballë gjithsesi, ngjanin sikur nuk e njihnin njëri-tjetrin.

E mbylla perden dhe vura re se në dorë mbaja ftesën festive. Ishte hera e parë që merrja një ftesë për në tribunën e 1 Majit dhe, ashtu si në çastin e parë kur ma dorëzuan, ende s'më besohej që në të ishte shkruar emri im. Jo më pak të befasuar kishin qenë sytë e zëvendës sekretarit të partisë. Nuk mund të thuash se kishte në to vetëm zili. Përzier me zilinë, spikaste habia. Dhe në një farë mënyre, kishte të drejtë. Unë nuk isha nga ata që dilnin nëpër presidiume e merrin ftesa për tribunat festive. Dhe ndonëse, siç e mora vesh më vonë, zëvendës sekretari e kishte dhënë vetë emrin tim, kur Komiteti i Partisë së rrethit kishte kërkuar emra të tjera dhe jo ata që propozoheshin vit për vit, prapëseprapë nuk e kishte fshehur dot habinë. E kishte dhënë vërtet midis të tjereve edhe emrin tim, por s'kishte besuar, me sa duket, se do të miratohej lista e re! Kështu thuhet çdo vit, kishte thënë ndoshta me vete, por prapë, kur vjen puna, shkojnë të përhershmit.

“Urime, urime!” më tha tek po ma jepte ftesën dhe në çastin e fundit, në vështrimin e tij, përveç zilisë dhe habitjes, m'u duk se pikasa diçka tjetër. Ishte mu në mes të buzëqeshjes së tij, pjellë e saj e njëkohësisht, tjetërsoj. Ndoshta, fjala më e saktë do të ishte nënqeshje. E përqendruar, pyetëse, disi ngacmuese, por, siç janë ngacmimet dashamirëse midis njerëzish që i lidh një e fshehtë. Ajo nënqeshje

dukej se po më thoshte: "kjo ftesë nuk të erdhi kota pëllumbth, apo jo? Me ç'shërbim vallë, e ke merituar? Urime, qerrata!"

Ishte kaq e qartë kjo pyetje, saqë e ndieva se po skuqesha. Madje ndjenja e bezdisë nuk m'u shqit gjatë gjithë rrugës për në shtëpi, ku disa herë pyeta veten: Vërtet, me se e kisha merituar atë ftesë?

Apartamenti ngjante edhe më i heshtur për shkak të zhurmërisë së rrugës. I heshtur dhe i zbrazët. Të gjithë kishin shkuar në vendin e grumbullimit për parakalim dhe hapat e mi, në vend që ta mbushnin, e shtonin edhe më tepër heshtimin dhe zbrazëtinë, që ishte gjithashtu e veçantë, si çdo gjë tjeter në një ditë të tillë.

Unë prisja Suzanën. Megjithatë, ajo çka më zgavronte gjoksin, nuk ngjante aspak me ankthin e zakonshëm të pritjes së një vajze. Ishte një ndjesi më shtypëse. E zmadhuar, me sa dukej, nga muzika dhe zallahia kapitëse që vinte nga rruga. Madje, nganjëherë më dukej se ndonjë nga ata portretet do të ngjitej aq lart mbi mbajtësit, sa të mbërrinte nivelin e drithares sime, të vështronë brenda apartamentit me ata sytë e piktuuar ngrirshëm: Ç'po pret këtu? Hm, hm, e ke lënë vendin bosh atje në tribunë, për një farë vajze, hë?

Nëqoftëse nuk vij gjer në tetë e gjysmë, mos më prit më, më kishte thënë Suzana.

Sa herë që më vinin ndër mend këto fjalë, sytë vetvetiu më shkonin te kanapeja ku ishte bërë biseda jonë e fundit. Ajo kishte qenë tejet e trishtueshme. Siç ishte vetë, gjysmë e zhveshur, edhe fjalët ashtu i dilnin Suzanës, gjysma-gjysma, duke e zbuluar me vështirësi kuptimin. Përherë e më vështirë e kishte të takohej me mua. Babai, çdo ditë ngjitej në karrierë. Tani familja e tyre ruhej më shumë se më parë. Para dy javësh, në pleniumin e K.Q., babai ishte ngjitur edhe më. Kështu që vetëkuptohej, ajo duhej të rishikonte mënyrën e jetesës, fustanet, shoqëritë. Ndryshe e dëmtonte.

-Eshtë ai që ta ka kërkuar këtë, (ende s'dija c'emer t'i vija), apo ti vetë e ke menduar?

Ajo më vështroi ngultazi.

-Ai, u përgjigj pas pak. - Por....

-Çfarë por?

-Kur ma shpjegoi, unë isha në një mendje me të.

-Ah, ashtu?

E ndieja se sytë duhej t'i kisha të skuqur gjak, sikur dikush të më kishte hedhur në to një grusht rërë. Me një ndjesi faji, ajo më mbështeti kokën te supi. Gishtat e saj, epruveta qelqi të thyera, të ftohtë, më përkëdhelnin flokët pas qafës.

Po pse, desha t'i them, pse vetëm ti? Fëmijët e tyre, të tjerët, përfitojnë përkundrazi nga kjo, për një jetë më të lirë. Veturat, vallëzimet nëpër vilat e

plazheve. Me siguri do t'ia thoshja këtë, sikur ajo të mos e përmendte vetë. Të tjerët i kishin lënë deri diku të lirë fëmijët e tyre, kurse babai i saj... Ai ishte me të vërtetë i çuditshëm. Kushedi ç'idera kishte në kokë... Ose s'ishte aspak i çuditshëm dhe kjo ishte diçka e detyrueshme, vetëm për të. Ngaqë, pikërisht ai po dallohej kohët e fundit mbi të tjerët. Kështu që, në festën e 1 Majit, nëqoftëse rrinte në krahun e djathëtë të Udhëheqësit, çdo gjë kishte marrë fund midis nesh.

Ngaqë nuk flisja, ajo kujtonte se nuk e kuptoja plotësisht. Më kuption? vazhdonte të fliste me dënesë. Ishte e papranueshme për të, domethënë për opinionin, që ajo të bënte dashuri me një djalë të fejuar. Sepse kjo do të merrej vesh një ditë. Sidomos tani. Më kuption? Do të merrej vesh patjetër.

S'dija ç't'i përgjigjesha, ndërsa sytë më kishin ngrirë mbi këmbët e saj të zbuluara.

-Ti gjithashtu do të dëmtohesh, - tha pas pak.

-Mua, aq më bën.

-Kështu thua, por më vonë do të pendoheshe. Aq më tepër tani, që ke shpresë për të shkuar për specializim në Vjenë.

Vazhdoja t'i mbaja sytë mbi pjesët e zbuluara të trupit të saj. Në të vërtetë, nuk isha i sigurtë nëse do ta këmbeja me gjësind tjetër, qoftë edhe me

Vjenën, atë trup, në bardhësinë e lëmimin e të cilit, ishte dhe vajza dhe gruaja. Shanz Elizetë e kofshëve të saj, Harkun e Triumfit në fund të tyre, me zjarrin e pavdekshëm rozë midis.

S'më kishte qëlluar ndonjë femër tjetër, që gjatë çastit të dashurisë, të ruante një përndezje buzëqeshëse në fytyrë, të tillë si të shihte një ëndërr sublime. Ajo derdhej nga mollëzat në nënkesën e bardhë, e cila, edhe pasi mbetej bosh pas ikjes së vajzës, më dukej se në terr e ruante për një farë kohe përndritjen, ashtu si ekrani i TV, që të jep përshtypjen se edhe pas shuarjes, e ruan një farë ndriçimi. E në çdo gjë të saj, ndihej menjëherë se e donte dashurinë me përkushtim të thellë, mallengjyeshëm dhe seriozisht.

## 2

Vështroja kanapenë e zbrazët, ndërsa në veshë kisha vazhdimisht muzikën e largët festive. Përmes saj, si në një sfond të kadifenjtë humbjeje, që rriste vlerën e gjithçkaje, më kujtoheshin copëra nga bisedat me të.

Nëqoftëse në 1 Maj... Po ti, kurrsesi s'duhet të mërzitesh... Mos kujto se unë do ta kem të lehtë... E di ç'do të thuash... Por ky flijim është i domosdoshëm... Unë do të të kujtoj përherë.

Ky flijim, kisha përsëritur me vete. Ja pra, cila ishte fjala e përshtatshme.

Ia besoja çdo fjalë, sepse çdo gjë e kishte patur gjithmonë seriozisht, dhe asnjëherë nuk kisha dëgjuar prej saj fjalë të kota, naziqe, apo të shtira. Nëqoftëse ishte e bindur se ai, flijimi, duhej bërë, ishte e kotë të përpinqeshe t'ia ktheje mendjen.

Dhe unë, vërtet nuk bëra asnjë përpjekje. Me orë të tëra pasi iku, u vërtita trishtueshmë nëpër dhomë, gjersa e gjeta veten përpara bibliotekës. Si gjysmë në ëndërr tërhoqa nga rafti librin “Mitet greke” të Grejvsit, që e kisha lexuar ato ditë dhe fillova ta shfletoj.

As atë çast, e as më vonë, nuk isha në gjendje të kuptoja se në ç’rrugë misteroze, mekanizmi i trurit tim e zhveshifjalën “flijim” nga kuptimi banal e i përditshëm, (shokë, koha kërkon sakrifica, në frontin e naftës, sakrificat e blegtorëve, etj., etj.), për ta çuar larg, shumë larg, në zanafillën e saj. Atje ku ajo ishte madhështore dhe e përgjakshme.

Kjo shtyrje në largësi duhej të kishte qenë dhe kapërcimi kryesor. Që këndej, gjer te analogjia midis flijimit, për të cilin porsa më kishte folur Suzana, dhe Ifigjenisë së grekëve, nuk ishte veçse një hap.

U krijuar tek unë analogjia, ngaqë Suzana përdori pikërisht atë fjalë, ngaqë babai i saj, ashtu si ai i Ifigjenisë, ishte një shef i lartë, apo thjesht, ngaqë libri i Grejvsit më kishte zhystur ato ditë në një atmosferë mitologjike?

Siq thashë, nuk isha në gjendje ta kuptoja këtë. Ashtu në këmbë, me etje, me padurim, rilexova gjithçka që thuhej përflijin e famshëm të vajzës së Agamemnonit. Pandehmat se, përsë mund ta kishte bërë shefi i grekëve këtë akt të kobshëm,

arsyet e përligjura, apo jo, gjer te mundësia e një flijimi të rrremë, pra të një inskenimi në sytë e ushtrisë (zëvendësimi i vajzës në çastin e fundit me një drenushe, etj., etj.)

Grekët përpara fushatës së Trojës  
Vajzën e Agamemnonit bënë fli.  
N'Iliadën e revolucionit  
Unë të flijova ty.

I kisha krijuar vetë këto vargje, ndërsa endesha i mërzitur nëpër apartament, pasi kisha lënë librin në raft, apo kujtesa i nxori nga ndonjë lexim i largët, i harruar? Trishtimi i thellë shfaqej shpesh teuri në formë përgjumjeje. Kështu isha atë ditë: i përgjumur dhe i paaftë të saktësoja gjérat. Nuk isha në gjendje të kthjelloja, për shembull, se cili ishte ai që fliste në këto vargje. Pra, cili ishte flijuesi, unë, apo ati i saj?! Herë më dukej se ishte ai, herë vetja ime, e më së shumti, se ishim të dy bashkë.

Zhurmat vinin nga jashtë të dobësuara. Ndihej përnjëherësh se rruga po boshatisej. Siç dukej, turmat që do të parakalonin ishin të grumbulluara tashmë në vendin e caktuar. Por shurdhëria ishte po aq shtypëse dhe armiqësore, sa edhe zallahia e pakmëparshme. Ajo të kujtonte çdo çast, se vendi yt ishte atje, midis gjallërisë festive dhe jo këtu, në veçim.

Ora e kishte kaluar tetë e gjysmën. Tani s'kisha më asnjë shpresë se Suzana do të vinte. Kishte qenë përherë e saktë në orar. Tani, gati sa s'po më vinte keq për këtë cilësi të saj, që aq herë e kisha bekuar, ngaqë më hiqte çdo shans të fundit shprese. U përpoqa të përligj pesëminutëshin e parë të vonesës, (asaj të drejte femërore, prej së cilës ajo vullnetarisht kishte hequr dorë). Pra u përpoqa ta përligj me çrrëgullimin e trafikut, gjë e zakonshme në ditë feste, por kjo, në vend që të më qetësonte, ma shtoi torturën e pritjes. Erdhi pesëminutëshi i dytë, më i zymtë se i pari, dhe unë disa herë e gjeta veten te dera, i gatshëm për të dalë në rrugë.

Kisha vendosur të prisja gjér në nëntë pa një çerek, pastaj të nisësha për në festim. Së paku, të mos i humbja të dyja. Shqetësimin se, ç'do të bëhej po të vihej re mungesa ime, e kishte mënjanuar njëfarësoj mendimi, se mjaftonte që ajo të vinte, pa do të bëja si do të bëja. (U ngatërrova në rrugë, rojet e kishin bllokuar kalimin para kohe, etj.). Pra, mjaftonte që ajo të vinte. Kurse tani që e kisha humbur, s'kisha pse të krijoja telashe me mosparaqitjen time. Veç kësaj, mund ta shikoja atje, në tribunë, ose pranë saj, në vendin ku zakonisht rrinin fëmijët e udhëheqësve.

Ky mendim i fundit, më bëri që ta flak lëkundjen. Në orën nëntë pa pesë, hapa derën dhe dola.

# 3

Shkallët e banesës ishin të shkreta, e po ashtu, rruga. Kishte vetëm kalimtarë tepër të rrallë. Ndjeva një farë lehtësie të parë, shkaktuar ndoshta, nga hapësira. Ngrita kokën si i tërhequr nga një shikim. Në njërin nga ballkonet, kishte dalë vërtet fqinji ynë. Vështronë rrugën, me shprehjen e zakonshme të përvajshme në fytyrë. Bëra një zhvendosje të hapave, për të dalë nga rrezja e shikimit të tij. Thuhej se ishte një nga ata që kishin qeshur ditën e vdekjes së Stalinit, gjë që ia kishte thyer përfundimi i karrierën shkencore, të nisur shkëlqyeshëm. Kishin kaluar kaq vite, megjithatë, me sa e mbaja mend unë, ajo shprehje vaji nuk i shqitej fytyrës së tij. Duhej të ishin një numër i pafund njerëzish, që kishin qeshur nëpër mitingjet e përmortshme atë ditë, së shumti fare kot, prej

shkurdisjes së mekanizmit të të qeshurit, gjë e njohur në raste të tillë, por që kurrsesi, nuk u pranua si shpjegim. U goditën pa mëshirë dhe tani, pas kaq kohe, mund t'i nijhje lehtë nga ajo shprehje e përvajshme, me të cilën, gjithë jetën duhej të paguanin atë të qeshur.

Ti shiko më mirë fytyrën tënde, i thashë vetes. Në të vërtetë, ajo s'duhej të ishte më pak e përqarë.

Si të kisha frikë, se mos zymtia ime tërhiqte vëmendjen, nxora ftesën dhe po vështroja kinse me vëmendje anën e sprapsme të saj, ku ishin shënuar pikat e kalimit për te tribunat.

Një pjesë e njerëzve që ishin ende në rrugë, duhej të ishin me ftesa si unë dhe kjo kuptohej, jo vetëm nga veshja, por nga gjithë paraqitja e tyre: mënyra e ecjes, e buzëqeshjes. Ajo i ndante ata prerazi nga kalimtarët e tjerë, ata që kishin dalë në rrugë, me shpresë se mos gjenin ndonjë skutë nga mund të shikonin parakalimin, apo që kishin humbur ndërmarrjet e tyre dhe që tani endeshin kot së koti, me një shprehje faji në fytyrë.

“Ruga e Barrikadave”, paralele me Bulevardin e madh, kishte më shumë njerëz. Herëherë që larg, ndoshta nga sheshi përpëra tribunave, vinin tingujt e bandës. Sa herë që i dëgjoja, shpejtoja hapat, megjithëse ora sapo kishte shkuar nëntë dhe s’kisha pse të ngutesha.

Të ftuarit ishin ende të përzier me kalimtarët e tjerë, por ja, pak më tutje fillonte një farë ndarjeje, fizike tashmë. Në krye të “Rrugës së Elbasanit”, në njërin trotuar lejohet kalimi për të gjithë, kurse në tjetrin, në të djathtë, ecnin vetëm ata që kishin ftesa. Kontrolli i vërtetë duhej të fillonte shumë më larg, ndërsa kjo ishte vetëm një tēharrje e parë. Megjithatë, shumica e të ftuarve parapëlqenin që të ndaheshin qysh tanë nga kalimtarët e zakonshëm, nën vështrimin e topitur të këtyre të fundit.

Vazhdoja të ecja në trotuarin e zakonshëm dhe po mendoja se Suzana mund të ishte ndoshta në tribunën C-I, atje ku e kisha vendin edhe unë, kur desh u përplasa me B.Ll.

Nuk e kisha parë prej vitesh. I gjatë dhe fytyrëqeshur, por me një të qeshur të ndryshme nga ajo që rrezatohej prej flamurthëve festivë, ai më përqafoi vrullshëm, madje dy herë rresht. Një shpërthim i tillë malli, ç'është e vërteta, m'u duk jo fort i përligjur. Kishim patur vërtet shoqëri vite më parë, kur unë vazhdoja Juridikun, kurse ai Institutin e Arteve, por jo të asaj shkalle, sa të ishim kujtuar shpesh për njëri-tjetrin.

-Si shkon? - më pyeti. - Ç'thotë gazetaria? Televizion, kamera, jetë moderne, s'ke ç'i thua.

-Po ti? - e pyeta unë. Akoma në N.?

-Eh, lëre, lëre, - tha ai me po atë shprehje

gazmore. Mua s'më ka ecur dhe aq. Në të vërtetë, isha në rregull, por pastaj, për shkak të një gabimi, më kanë çuar të punoj me grupet amatore në fshat.

-Ah, ashtu?

-Po, besa. Vura në skenë një dramë me tridhjetedy gabime ideologjike. Ta merr mendja? Nejse, shyqyr që shpëtova paq!

Duhej të kisha një pamje midis habitjes dhe mosbesimit, sepse ai vazhdoi:

-Me siguri të duket se po bëj humor, por të thashë të vërteten.

Dhe ai përsëri i përmendi ato tridhjetedy gabimet ideologjike, me ton të shkujdesur, pa kurrfarë ankesë, apo pérçmimi. Madje do të thosha se foli për to me një farë hareje, për të mos thënë me admirim të fshehur, i cili nuk kuptohej mirë, nëse ishte për ata që kishin patur aftësinë të qëmtonin një nga një gjithë ato gabime, për atë vetë, që kishte arritur të bënte, jo një gabim të rëndomtë, një gabimth, por një hata të tillë kolosale, apo për të dy palët?!

-Ja kështu, - tha ai. - Njëzetegjashtë ata ishin, njëzetegjashtë; varret e tyre s'i mbulon dot rërë e lashtë.

Asnjëherë s'e mora vesh se ç'hynin këtu vargjet e Eseninit.

Ndërkaq, po afrohej udhëkryqi, ku të ftuarit

ndaheshin përfundimisht nga kalimtarët e zakonshëm. Pavarësisht se, në rrethana të tjera, s'do t'ia tregoja kurrsesi ftesën ish-shokut tim që vuante një dënim, tani isha i detyruar ta bëja këtë. Përkoi tamam me pyetjen e tij: "po ti, si i ke punët?", pas së cilës unë, jo pa siklet, duke buzëqeshur si i zënë në faj, nxora ftesën dhe i thashë:

-Siç e sheh, jam i ftuar atje, kështu që..

Nuk dija si ta vazhdoja fjalën, me shaka, seriozisht, apo me një ironi që s'dija as vetë se ndaj kujt drejtohej, ndaj meje, atij vetë, apo fatit, kur ai lëshoi një britmë gazmore, që më çlroi përmjëherësh.

-Ah, paske ftesë? Të lumtë! Gëzohem, gëzohem shumë. Ndoshta të duhet të shpejtosh, mos je vonë?

As në fytyrën, as në zërin e tij, s'kishte kurfarë ironie, ose zilie të fshehur dhe unë ndieva një vrasje ndërgjegjeje për ato njëzetë metrat e fundit, kur po mendoja se do ta kisha vështirë të shkëputesh prej tij.

Matanë udhëkryqit, para se të arrija kordonin e parë të policëve civilë, ktheva dhe një herë kryet dhe e kapa fytyrën e tij, që po më përcillte gëzueshëm, ndërsa ma bënte me dorë.

Isha pak i befasuar nga mirësia e tij. Megjithatë, dyshimi se mos kjo ishte thjesht një shenjë degradimi e njeriut, që për arsyen jo fort të

shpjegueshme dashurohet pas rënies së vet (dyshim që në rrethana të tjera do të më mundonte), këtë herë u shpërnda prej atij vrundulli hareje, dashamirësie, që ma bëri aq të lehtë kontaktin e parë me kordonin e policëve.

-Pasaportën!

Me bisht të syrit ndoqa lëvizjen e vështrimit të civilit, nga fotografia e pasaportës, tek fytyra ime, duke u përpjekur, kushedi pse, të pikas në të shenjën e mosbesimit, të dashakeqësisë, apo të respektit. Pak çaste më vonë, ndërsa po largohesha, mendoja se ishte vërtet një tuafëri nga ana ime që të shqetësohesha sadopak se ç'ndjesi do të provokonte fytyra, emri, apo ftesa ime, te njëfarë polici civil që, ndoshta s'do ta takoja më kurrë në jetë.

Bulevardi “Marsel Kashen”, që bashkonte “Rrugën e Elbasanit” me Bulevardin e madh, ishte i bllokuar krejtësisht për kalimtarët. Përgjatë tij, grupe-grupe, ose të vetmuar si unë, ecnin vetëm të ftuarit. Disa kishin me vete fëmijët, që mbanin në duar flamurthë, ose lule artificiale. Të tjerë kishin vënë dekoratat, prarimi i të cilave reflektohej mbi fytyrat e tyre. Një burrë i shkurtër ecte gjallërisht përpara meje me dy vajza të vogla për dore, njëra me kordele të kuqe, tjetra blu dhe me fytyra të atilla, që mund të ishin tipike për çdo kuadër filmi dokumentar festiv.

Kordoni i kontrollit të dytë nuk ishte larg të parit. Prisja që ai të ishte më serioz, kurse në të vërtetë, u përsërit e njëjta procedurë, gjë që do t'i zhgënjen, me siguri, disa nga ata që vinin për herë të parë dhe që shpresonin për një kontroll tejet të rreptë, serioziteti i të cilët, do t'ia shtonte vlerën ftesës që kishin marrë. Kaq e vërtetë ishte kjo, saqë burri me dy vajzat e vogla që kaloi para meje, e tregoi haptas njëfarë pakënaqësie kur, pasi u tha rojeve se ato ishin vajzat e tij dhe se ai kishte me vete çertifikatat e tyre të lindjes, dy prej policëve i thanë me mospërfillje: Kaloni!

Burri tundi kokën si të thoshte: eh, vigjilencia! Kaq haptas e tregoi këtë, saqë unë pata dëshirë të ndërhyj e t'i them: mos u bëni merak, gjer te tribunat do të ketë kontolle të tjerë, shumë më seriozë!

Kjo pjesë e bulevardit “Marsel Kashen”, përveç se ishte e gjerë, ishte dhe e harkuar, kështu që shiheshin pothuajse krejt grumbujt e të ftuarve. Ata ecnin njëri pas tjetrit, me një ngutje të përbajtur në diellin pranveror, që bashkë me medaljet, flamurthët dhe tingujt e muzikës që sa vente dëgjohej më qartë, krijonte midis të panjohurve, një solidaritet ngazëllues. Dhe kjo ishte e kuptueshme. Vetë fakti që ishim żgħedhur inga e njëjta dorë (dora e shtetit), për të njëjtin gëzim

solemn, na krijonte një aleancë praruese, dëshirën për t'i folur e për t'i buzëqeshur, qoftë edhe pa shkak, njëri-tjetrit. Në fund të fundit, kalimtarët e tjerë, të zakonshmit, të paftuarit, kishin mbetur përtej kordonëve të kontrollit, për të mos na shqetësuar me atë vështrimin e tyre të topitur, pyetës, ngulmues: përse je ftuar pikërisht ti?

Më vinte turp nga vetja për këtë paqe festive, dhe befas, ndjeva një dëshirë mallëngjyese për ta parë përséri B.Ll., atë që e kisha takuar jo pa një farë bezdie, kurse ai qe treguar aq fisnik, saqë jo vetëm nuk ma kishte bërë pyetjen e mallkuar, por sinqerisht qe gjëzuar përmua, megjithëse vetë, prej kohësh kishte mbetur jashtë çdo gostie.

Në kontrollin e tretë njoha një aktivist të lagjes sonë. (Vetëm tani e kuptova se me policët civilë qenë përzier gjithfarë punonjësish të tjerë të Ministrisë së Brendshme, si dhe veprimitarë të lagjeve, me siguri edhe këta bashkëpunëtorë të fshehtë). Në rrethana të tjera, do ta shikoja me përbuzje, por këtu, nën prarimin festivo-bashkues-harrues, pata dëshirën ta përshëndes me buzëqeshje. Mirëpo ai, jo vetëm nuk iu përgjigj buzëqeshjes sime, por bëri sikur nuk më njoihu. E shfletoi ftohtësisht pasaportën time, thua se nuk më kishte parë kurrë, ndonëse çdo ditë takoheshim te dyqani i qumështit, dhe pa më vështruar në sy, tha: Kaloni!

Një grimë ndjeva faqet të më skuqen nga fyerja, por s'u desh të kalonin veçse ca çaste, që ftohtësia e tij të më shkaktonte një kënaqësi të turbullt. Kjo tregonte se, pavarësisht se unë gjendesha atë ditë në radhët e të zgjedhurve, dhe pavarësisht se turbull, fare turbull, kjo gjë, bashkë me turpin, më shkaktonte njëfarë joshjeje, prapëseprapë nuk isha njëjtësuar me bashkësinë e tyre, ose më saktë, me anën e keqe të saj. Ja ai, aktivisti i lagjes më kishte parë gjithë ligësi. Me siguri kishte hungëruar me vete: po ky, ç'do këtu? Kush i zgjedhtë tillët, për në tribunë?

Kaq u desh që unë të vija re sinjalet e ligësisë. Sa më tepër që i afrohesha Bulevardit, aq më tepër ajo shtohej. Por kjo ishte e keqja më e vogël. Pikërisht atëherë kur s'e prisja, kur kujtoja se këndej e tutje do të më duhej të mbrohesha vetëm nga zilia, (ishte e kuptueshme që njerëzit që ishin mësuar të ishin përherë në listat e të ftuarve, të shikonin me armiqësi të ftuarit e rinj), pra kur kujtova se do të më duhej të mbrohesha vetëm nga smira, kurse ajo tjetra, pyetja dyshimtare, “po ky, me ç'shërbim e ka merituar këtë ftesë?”, këtu përjashtohej, ngaqë të gjithë ishim në pozitë të barabartë, si të thuash, të baraspërlyer, pikërisht atëherë, ajo u shfaq më haptas se kurrë. Ishin dy burra të rinj, me pardesy, nga ato fytyra që të duket se diku i ke njojur, por

s'je i sigurtë se ku, që më vështruan shkarazi, ndërsa ecnin përbri meje. Pata përshtypjen se shikimi i tyre ishte shoqëruar nga një ndriçim ironik. Ktheva kokën për të vërtetuar të kundërtën, domethënë që ata nuk e kishin me mua dhe, se po bëhesha maniak kot së koti, kur, për tronditjen time, u binda se ata e kishin pikërisht me mua. Jo vetëm që vazhduan të më shikonin njëlloj si më parë, por diçka pëshpëritën me njëri-tjetrin, ndërsa buzëqeshja therëse, sa vinte e dendësohej rrötull gojëve të tyre.

E ndjeva se po skuqesha. Mendimi për të shpejtuar hapat, m'u shndërrua aty për aty në të kundërtën e vet, të qëndroja në vend dhe t'u thoshja: ç'keni që zgërdhoheni si gratë e liga? Unë kam po aq të drejtë të dyshoj për ju, apo jo?

Nuk bëra, as të parën, as të dytën, po vazhdova të eci, duke u përpjekur më kot ta heq mendjen prej tyre. U qetësova disi, kur midis nesh hyri një grumbull i gjëzueshëm. Midis tyre më zunë sytë burrin e shkurtër me dy vajzat e vogla, njëra me kordele të kuqe e tjetra me blu.

Me vete vazhdoja polemikën me dy të panjohurit. Përse ju paskeni monopolin e dyshimit, e unë jo? Në fund të fundit, ç'përparësi keni ju në krahasim me mua, lidhur me këtë çështje?

Kështu thoshja me vete, por s'di pse më dukej


se, asgjë s'mund ta shkatërronte atë buzëqeshje ironike të të dy të panjohurve. Dhe befas, m'u duk se e gjeta çelësin e enigmës: përparësi kishte ai që dyshonte i pari. Tjetri, pavarësisht se mund të ishte i pafajshëm, ishte inferior, për vetë faktin që ishte vonuar.

C'marrëzi, thashë me vete. Më kot përpinqesha të sillja nëpër mend ç'kisha lexuar për ndjesinë e fajit kolektiv, etj., etj. Por asgjë s'më kujtohej.

Përpara meje, dy vajzat e vogla me kordele se ç'pyesnin diçka me zërat e tyre cicërues. I ati u përgjigjej me durim, duke shtuar nofka përkëdhelëse për secilën prej tyre.

Prind ideal me vajzat për dore, në diellin e majit socialist. Tablo idiliqe, mendova, veç më thuaj, me çfarë çmimi e ke siguruar këtë idil? Kë ke çuar në internim?

U habita dhe vetë për këtë shpërthim egërsie. Por kjo s'më ndaloi që të vështroja me hakërrim djathtas e majtas. Isha si ai terroristi i verbuar nga gjaku, që shtie kuturu midis turmës. Sa të më godisnin ata të parët, le t'i godisja unë! I humbur ishte ai që vononte.



Zemra e vogël salalëzoi  
një hidhërim seç e pushtoi  
jetojë jidon siç tò vijë  
e mos pë Kurraq ligesi?

4

Pas pak e ndjeva ballin të mbuluar me djersë  
të ftohta. I kisha humbur nga sytë ata dy burrat  
me pardesy, si dhe tablonë idilike me kordele të  
kuqe dhe blu. Po ecja midis të panjohurish, që i  
kisha akuzuar ndërkaq pa asnje ngurrim, u kisha  
hedhur baltë e llum mizorisht, verbërisht, pa çarë  
kokën aspak se, edhe ata mund të më bënin të  
njëjtën gjë.

Bulevardi i madh nuk ishte larg. Po ti, a s'ke  
gjë për të shqyrtuar në ndërgjegjen tënde? mendova.  
Para gjashtë muajsh, duke dalë nga Komiteti i  
Partisë së rrethit ku na kishin thirrur për ballafaqim,  
e kisha bërë së pari këtë pyetje. Ashtu si atëherë,  
edhe tanjundi kokën në mënyrë mohuese. Jo,  
s'kisha asnje papastërti në ndërgjegje. Edhe  
nëqoftëse padashur isha bërë shkak që dy shokë të

mi nga zyra fqinje, të dërgoheshin me dënim në fshat, kjo s'ishte përfajin tim. Përkundrazi, mund të thuhej se ata desh më morën në qafë mua, ngaqë u treguan të trashë. Këtu jemi në Komitet të Partisë dhe duhet ta dini, se në Komitet të Partisë nuk gënjetet, tha sekretari, duke na shigjetuar radhazi me sy. Ti, m'u drejtua mua, ku e ke dëgjuar mendimin e mbrapshtë, se pëshpërimat dhe thashethemet politike përrënien e afërt të këtij apo atij funksionari të lartë, nuk përhapen rastësisht në popull nga elementi mikroborgjez, por përpunohen prej vetë shtetit, domethënë sipas teje, nga një zyrë e fshehtë speciale, me qëllim përfshirja të përgatitur vërtet rënien e zyrtarit në fjalë?

Nuk e kisha ndjerë ndonjëherë veten më ngushtë në jetën time. Ato fjalë m'i kishte thënë, në të vërtetë, fqinji im i zyrës, që rrinte fytyrështangur përbri meje, po unë nuk e dija që ai ndërkaq, e kishte pohuar këtë. Pa u menduar gjatë, me një bindje të çuditshme, që, sa më tepër kalonin sekondat, aq më shumë po i besoja dhe vetë, thashë se atë mendim e kisha lexuar në një libër që fliste për Çekosllovakinë pas pushtimit sovjetik. Sytë e sekretarit hetonin kujdeshëm fytyrën time, por unë ndërkaq i kisha mbushur mendjen vetes, se diçka të ngjashme kisha lexuar vërtet në atë libër. Për këtë shfaqje të sinqeritetit kallp më ndihmonte fakti se,

sapo kisha mbaruar së lexuari vërtet një libër për Çekoslovakinë.

Nuk e di se çfarë i pëlqeu sekretarit në përgjigjen time. Normale ishte që ai të çmonte sinqeritetin e shokut tim, që, duke rrezikuar veten, kishte pohuar të vërtetën, dhe të dyshonte përmua. Mirëpo ndodhi e kundërtat. Pa iu lënë kohë të bënин asnjë sqarim, (shyqyr, kishin thënë më vonë që të dy, ne tamam atë donim, të mos na kërkoheshin sqarime), ata të dy u quajtën llafazanë të tresskshëm, kretinë, mitomanë, mburravecë, që hiqeshin sikur merrnin vesh nga politika, kurse në të vërtetë, s'kuptonin asgjë. Thashethemexhinj të sëmurë, të cilët, ç'dëgjonin për realitetet e shëmtuara në vendet borgjezo-revizoniste, ia vishnin me mendjelehtësi realitetit tonë socialist, etj., etj. Kurse unë hëngra një nga ato kritika që tingëllojnë më tepër si lavdërim. Domethënë, që më i vëmendshëm duhej të isha treguar në shpjegimin e këtyre dukurive, për të shmangur keqkuptimet që mund të shkaktonin biseda të tillë, sidomos kur ishte fjala për njerëz mendjelehtë e, jo të formuar mirë politikisht, si dy shokët e mi.

Dhe tani, marsh, dhe asnjë fjalë askujt për këtë, morët vesh!? Këto ishin fjalët e fundit të sekretarit. Për një kohë të gjatë më mbeti enigmë qëndrimi i tij, si dhe mbyllja e papritur e çështjes. Ishte vallë

një nga ato ingranazhet e verbëra që, në vend të rrotullohen në njërin drejtim, kthehen papritur në tjetrin, duke shkaktuar kështu një sërë alogjizmash, apo sekretarit iu duk tepër komode mbyllja e incidentit me një faktor të jashtëm, si Çekoslovakia? Apo thjesht, sekretari kishte patur shumë probleme ato ditë, kritika nga lart për mosrealizimin e planit, etj., etj., në kohën që ajo çështje i zvarrisej nëpër këmbë dhe ai donte të çlirohet sa më shpejt prej saj?

Ai gati sa nuk më shikonte me simpati që e shkarkova nga kjo barrë. Madje, kur po dilnim, m'u duk se do të më vinte dorën në sup, me atë gjest që aq herë e kisha parë në filmat e kinostudios “Shqipëria e Re”. Por edhe pa atë gjest, ditë me radhë nuk m'u nda mendimi se ç'do të thoshnin njerëzit për mua. Dhe kjo ishte e natyrshme, përderisa prej tre të ngatërruarve në këtë histori, vetëm unë po dilja i paprekur. Ishte një fat për mua që ata të dy, përpara se të largoheshin për në fermë, kishin thënë andej-këndeje se unë s'kisha asnje faj, se çdo gjë ua kishte bërë koka dhe se, shyqyr që kjo punë që mbyllur me kaq, ndryshtë, mund ta pësonin edhe më keq.

Më vonë, ndërsa i rikthehesha asaj dite, përherë e më shpesh më vinin në kujtesë fjalët “Dhe tani, marsh dhe asnje fjalë askujt për këtë!”. Ngutja

e sekretarit për mbylljen e çështjes, mirënjojja ndaj meje dhe sidomos, prirja që e gjithë kjo të trajtohej në radhë të parë, si mendjelehtësi, punë kretinësh e mburravecësh mitomanë, ma qartësuani dalëngadalë, atë që më qe dukur si enigmë. Kurrfarë enigme s'kishte patur këtu, as alogizma të krijuar nga vërtitja e verbër e ingranazheve. Dhe as ishte fjala për lodhjen e sekretarit prej problemeve. Ishte thjesht një gjetje dinake, e vetmja, ndoshta, për t'i prerë rrugën pëshpërimës. Në të vërtetë, ishte një nga ato pëshpërimat e hidhura që shtetit i interesonte ta mbyllte me çdo kusht.

Kështu ndodhi që, gjatë shpalljes së dënimit të tyre, shkaku i vërtetë s'u zu në gojë fare, por u gjetën ca gabime në punë, nga ato që mund t'i gjenden në çdo kohë, cilitdo.

Në të vërtetë, logjike ishte që shteti të mbyllte njërin sy dhe ata të mos dënoheshin fare. Por kushedi ç'ingranazh vazhdonte të vërtitej i vëtmuar, në drejtimin që kërkonte dënimin me çdo kusht. Apo ishte diçka tjetër, që unë nuk e kapja dot?

Të gjitha këto m'u kujtuan kaotikisht, ndërsa po i afrohesha Bulevardit të madh. Pas kaq muajsh qetësie, dyshimi se mos dikush nuk e kishte të qartë atë që kishte ndodhur, me gjerryu përsëri. Në të

vërtetë, kushdo nga të njohurit që do të më shikonte në tribunë, kishte të drejtë të mendonte keq. Unë vetë, dy-tri herë kisha pyetur veten: mos kisha shërbyer si një vegël e verbër për të zhytur thellë e më thellë shokët e mi? Në fund të fundit, akuzën se i vishnin realitetit socialist mbrapshtitë revizioniste, e kishin prej meje.... Pa le pastaj, po të më shikonin ata të dy sonte në ekranin e TV. Me siguri do të thoshnin: patëm kujtar se na lehtësoi, por ai na paska varrosur, madje thellë, përderisa është shpërblyer kaq bujarisht.

Më mirë të mos ma kishin dhënë fare atë ftesë, mendova. Ose të mos kisha ardhur këtu, ashtu siç e kishim lënë me fjalë me Suzanën. Dhe befas, gjithë trishtimi i mosardhjes së saj, më pllakosi me peshën e një guri varri. Gjithë të këqijat të grumbulluara bashkë, o Zot, mendova.

Atje ku ndërpriteshin dy bulevardet, ishte një kordon tjetër kontrolli, më i rreptë se të tjera. Por unë isha tanë fare mospërfillës. Një dëshirë e fshehtë që rojet të gjenin në ftesën time një parregullsi e të më kthenin mbrapsht, më lindte sa herë i afrohesha kontrollit të ri.

Por kjo ishte një shpresë e kotë. Kishte ca punë, ku nuk ndodhë kurrë të kishte ngadalësi, harresë, apo mungesë zelli. Përpilimi i ftesave hynte në kësij lloj punësh.

Të dy trotuaret e Boulevardit të madh ishin plot. Shumica e të ftuarve e kishin vendin pikërisht këtu. Madje, kështu e kishin të shënuar edhe në ftesë “Anash tribunës”. Kurse ne, të ftuarve të tribunës, do të na duhej të çanim përmes kësaj tallazitjeje. I kisha tërhequr dyshimet dhe urrejtjen vetëm me rrugën gjer këtu, por kur të merrnin vesh se isha për më tutje, për më lart, kushedi ç’ligësi e re do të shpërthente. Madje, e keqja më e madhe do të niste pikërisht këtu. Nganjëherë më dukej se kur ta merrnin vesh, do të më kapnin nga xhaketa për të më mbajtur, për të dhënë alarmin.

Vetvetiu ngadalësova hapat, për të hequr çdo dyshim se kisha për të ecur më tej. Doja të jepja përshtypjen, se lëvizja vetëm sa për të gjetur një vend të përshtatshëm për të qëndruar, ashtu siç bënин тe porsambërriturit.

Pas pak vura re, se trotuari i ngjante pak a shumë, një shëtitoreje. Ngaqë vendet më të mira për të soditur parakalimin ishin zënë prej kohësh, të ftuarit e tjerë zdërhallezin andej-këndej, takonin të njoherit, qeshnin hareshëm. Aty-këtu vezullonin medaljet e më rrallë, midis tyre, ndonjë yll “Heroi i punës socialiste”. Një syri të jashtëm, nga ata që pak më parë kishin ndjekur si të topitur ecjen tonë drejt tribunës, ky mjesid do t’i dukej si një kënd i parajsës. Një grumbull njerëzish të zgjedhur të

socializmit, nën diellin prarues të majit, pranë muzikës hyjnore...

E megjithatë, mendova, edhe pse nuk ishte kështu, edhe pse s'ishte aspak një kënd parajse, ndoshta nuk ishte as skaji tjetër, një zgrip ferri, siç më qe dukur pak më parë. Ndoshta gjërat ishin më të thjeshta dhe ishte ndërgjegja ime e turbulluar, që dendësonte dramacitetin e tyre.

I lehtësuar disi, pashë orën. Po shkonte nëntë e gjysëm. Ndoshta ishte tamam koha për t'u nisur drejt tribunës. Ja, midis masës njerëzore ishte krijuar një farë njëshkolone e atyre që po shkonin andej dhe, për habinë time, nuk po pikasja ndonjë shenjë faji, turpi apo drojtjeje në fytyrat e tyre. Përkundrazi, shumë prej tyre, jo pa njëfarë krenarie, mbanin në duar ftesat, i afronin ose i largonin pak nga sytë, kinse për të parë se në ç'tribunë e kishin vendin, (thua se nuk kishin patur kohë ta bënin këtë punë, madje me dhjetëra herë në shtëpitë e tyre), dhe vazhdonin të ecnin ashtu, me fytyra serioze, drejt e përpara.


Do të vihesha edhe unë në atë njëshkolonë dhe s'do të çaja më kokën për asgjë. Në fund të fundit, ata kishin vite që po vinin, kurse unë po vija për herë të parë. Dhe me siguri, të fundit.

Përpara, përpara,  
Përpara gjithmonë

këndonte një zë në altoparlantin më të afërm, si të më jepte zemër. Ose, si për të ironizuar me vendimin tim. M'u duk se do të buzëqeshja me vete, por ajo më ngriu në buzë. Nga e djathta, midis një grupi burrash të rinj, shumicën e të cilëve e njihja, (një pjesë punonin në “Zërin e Popullit”, të tjerë në aparat të K.Q.), pashë R.Z.

Nuk e di, nëse do të kishte në gjithë atë turmë të madhe dikë tjetër, që aq vetëtimthi do të më kujtonte diçka të keqe, të errët e të pashpresë. Një vrimë e zezë, një rënie, një përpëlitje mortore për të dalë me çdo kusht nga kaosi... Po, kjo ishte përralla e moçme e Qerosit që u rrëzua.

Një natë, tek ecte nëpër terr, Qerosi u rrëzua në një vrimë dhe bjer e bjer, ra në botën e poshtme...



## 5

E kisha njojur R.Z. qysh nga koha kur kishte punuar tek ne në televizion dhe s'më kishte pëlqyer asnjëherë. Ishte i hirtë, po me atë lloj hirnosjeje të keqe, si të palarë, që e bashkuar me këmishat jo fort të pastra që mbante, e aq më tepër me adhurimin gjoja të së thjeshtës, që s'ishte veçse adhurimi i varfërisë, dhe me faktin që shpesh nëpër mbledhje, nënvizonte jetimërinë e tij, (unë, shokë, kam qenë jetim, nënë më është bërë Partia...) gjë që i mallëngjente së shumti të deleguarit, kurse një shokun tònë, e tërbonte, (o Perëndi, ç'sharlatan, hungërinte ai, po ky në të vërtetë e ka nënën, veç babai i ka vdekur, ahere, pse s'thotë se baba i është bërë Partia), pra, të gjitha këto të mbledhura së bashku, të ngjallnin vetvetiu dëshirën ta quaje së paku “qelbanik”.

Mirëpo pikërisht atje duhej të ishin edhe rrënjet e karrierës së tij. Sepse që të bësh karrierë, siç thoshte një shoku im, përveç zellit e shërbimeve të ndryshme, duhet të kesh një të dhënë të veçantë, të tillë, që vetëm një fije e ndan nga kodet gjenetike të njeriut. Dhe kjo e dhënë, që te disa ishte shpirtkazmëria, pabesia e lindur, servilizmi, apo dreqi e di çfarë, te R.Z. ishte jetimëria e tij e humbët, e pistë, që kushedi pse, krijonte te zyrtarët, sigurinë se ai do të shkelte mbi gjithçka, po t'i kërkohej.

Dhe vërtet, kishte bërë një farë karriere. Në fillim në radiotelevizion, pastaj në Teatrin Kombëtar, ku, siç thuhej, e kishin në sy të mirë fort. Ndihej menjëherë që kishte një ethe të padurueshme të ngjitej, të ngjitej... Mirëpo një natë, një kushërim i tij u arrestua...

Një natë, Qerosi ra në botën e poshtme...

Nuk më kishte shkuar në mend se një nulitet i tillë si R.Z., mund të bëhej shkas për përqasjen në ndërgjegjen time të përrallës së famshme të vjetër, me një dukuri të rëndomtë të jetës së sotme. Por, siç thoshte shefi ynë i zyrës, sa herë qëllonte që insekte të ndyta e pa vlerë, të çonin në mendje gjëra të mëdha? Pas rënies së trishtë, Qerosi bëri çmos për të gjetur udhën dhe mënyrat që të ngjitej prapë në botën e sipërme. U rrek sa u rrek andej-këndej,

gjersa një plak ia tregoi mënyrën. Njihte një zhgabonjë që mund ta ngjiste në krahë gjer atje, veç me një kusht: gjithë rrugës, zhgabonja donte të hante mish! Qerosit nuk iu duk ndonjë kusht i vështirë.

(Ç'i kishin kërkuar vallë R.Z., që të ngjitej prapë në botën e sipërme? Mishin e kujt?)

R.Z. kaloi ditë dhe netë të tëra si në delir. Vërtitej andej-këndej nëpër dyer zyrash të ndryshme, mallkonte kushëtirin, e mohonte, deklaronte se ishte gati ta mbyste me thonjtë e vet, kërkonte që Partia ta vinte në provë. Ata që e njihnin nga afër, thoshnin se përndezja e tij nuk ishte e shitur. Kjo iu dukej me njëfarë vlere. Kurse mua, sa e dëgjova, m'u duk se tamam kjo, përbënte kulmin e degradimit njerëzor.

Ai vërtitej, rrekej andej-këndej për të gjetur rrugën e daljes, i dashuruar pas përuljes së vet, pas gatishmërisë për të shërbyer, i habitur ndoshta dhe vetë, se ç'rezerva përkushtimi ndaj Partisë mund të kishte njeriu. Ai endej pra zyrë më zyrë, e korridor më korridor, gjersa dikush ia tregoi më në fund mënyrën për t'u ngjitur përsëri. Njihte dikë, por me një kusht...R.Z. nuk iu duk ndonjë kusht i vështirë.

Askush nuk mundi ta mësonte se, çfarë iu kërkua në fillim R.Z.

Në botën e poshtme, Qerosi siguroi një sasi mishi, i hipi zhgabonjës dhe kështu nisi udhëtimi i tyre drejt botës së sipërme. Rrugës, zhgabonja kërkonte herë pas here mish dhe Qerosi i priste nga një copë.

R.Z. i qe ndaluar e drejta e botimit, megjithatë, nuk e kishin lëvizur hë për hë nga Teatri. Ai iu kishte thënë miqve të ngushtë, se puna e tij do të sqarohej shpejt. Dy-tri javë, e shumta katër-pesë, dhe fati i kushërit do të ndahej prej fatit të tij. Aq më tepër që ai ishte me gjysh tjetër... Por sqarimi nuk mbaroi, as pas dy-tri, as pas katër-pesë javësh...

Fluturimi i zhgabonjës drejt botës së sipërme po vazhdonte më gjatë se ç'e kishte menduar Qerosi. Mish qe mbaruar ndërkaq, dhe i ngrysur ai vështronte honin e zi, përmes së cilit iknin. Honi dukej i pambarim.

Krau, krau, ia bëri zhgabonja dhe kjo ishte klithma e saj e urisë. Qerosi dridhej nga tmerri. Ç'ti jepte? Nëqoftëse nuk i jep mish sa herë që të të kérkojë, ajo do të të rrëzojë në humnerë, i kishte thënë plaku.

Krau, klithi për së dyti zhgabonja. Qerosi, pa u menduar gjatë, i ra me thikë krahut të vet dhe këputi një copë.

Askush nuk mundi ta mësonte me saktësi se çfarë arriti të bënte R.Z. gjatë javës së provës së

tij. U mor vesh vetëm një provokim që bëri në një mbledhje partie, kundër një dramaturgu të njojur. Pas kësaj disa vjersha kushtuar udhëheqësit të vendit, që ai ua çoi fëmijëve të tij, me anë të një rojeje që e njihte, bashkë me ankesën se këto vjersha s'mund t'i botonte dot, për arsyen që dihej. Së fundi dhe më kryesorja, arrestimi i një kineasti të ri në bazë të komentit, (me siguri dhe të denoncimit), që R.Z. i kishte bërë një skenari të tij.

Vura dorën në tëmtha për të më çliruar pak dhimbjen e kokës. Jo, historia e Qerosit që po ushqente me mishin e vet zhgabonjën infernale, ndahej këtu nga historia e R.Z. Asnjë grimë nga mishi i vet, veç mish të huaj mund të hidhte në gojën e zhgabonjës R.Z. Prerja e gjymtyrëve të veta, në çfarëdo rasti, kishte një ngjyrim tragjik dhe një madhështi funebre, gjëra krejtësisht të huaja për R.Z. dhe tipat si ai. Asnjë thua s'do t'i hiqnin ata vetes për askënd... Kurse Qerosi...

Krau, krau, klithi zhgabonja pas njëfarë kohe dhe ai u detyrua të shkëpuste një copë mishi nga kofsha e vet. Trishtueshmë vështronte honin e zi humneror, fundi i të cilit nuk dukej. Pastaj sytë e tij qëndruan me radhë mbi ato pjesë të trupit që do t'i duhej të priste, kur zhgabonja të kllithe përsëri. O Perëndi, dhimbnin të gjitha njëlloj!

Zhgabonja fluturonte e fluturonte përmes gjysmëterrit të ftohtë. Ajo krakellinte herë pas here dhe ai i binte me thikë, herë njërsës anë e, herë anës tjetër të trupit të vet. Udhëtimi s'kishte të mbaruar. Herë-herë, atij i dukej se diçka zbardhte turbull në largësi. Por s'ishte veç një gënjam i syve të lodhur.

Krau, krau... Kishte nisur të jepte pjesë nga gjoksi i tij, ngaqë pjesët e tjera të trupit ishin pothuajse të zhveshura. Përsëri larg dukej sikur zbardhëllonte diçka...

Nuk dihej nëse e kishte ndërgjegjen, në kohën kur zhgabonja arriti ta nxirrte më në fund në botën e sipërme. Dihej vetëm se njerëzit e kësaj bote, ata që ndodheshin rastësisht përjashta, vështronin, pa iu besuar syve, një shpend të madh të zi që kishte sipër krahëve një skelet njeriu. Ej, shikoni një gjë të çuditshme, i thërrisinat ata njëri-tjetrit që larg. Një zhgabonjë që bart një skelet të vdekuri...

## 6

E kisha humbur nga sytë dhe s'doja ta kujtoja më. Të tjerë ishin ata që, për arsyen të ndryshme, kishin prerë copa të vvetves, që fati të mos i lëshonte të rrokulliseshin nëpër honin pa kthim.

... Unë vetë isha ndoshta një nga ata. Kishim nisur një udhë, pa e ditur se ku na çonte, pa e ditur sa do të zgjaste, dhe pastaj, gjatë udhëtitimit, kur e pamë se ishim gabuar, se ishte vonë dhe se ishte e pamundur për t'u kthyer, për të mos na gëlltitur terri, secili kishte filluar të jepte copa të vvetves.

Vazhdoja të férkoja tëmhat me dorë. Rreth meje, zhurmëria dhe muzika festive ishin shkrirë në një. Kurse unë isha larg, në humnerën e zezë pambarim, atje ku duke notuar humbshëm, një këtu, një aty, ne udhëtonim secili mbi zhgabonjën e vet.

-Ej, ti këtu? Qenke shastisur fare. Gëzuar festën, nipçë!

Ishte xhaxhai im që, bashkë me gëzimin që më shihte, nuk e fshehu dot habinë e tij. Ajo ishte kaq e madhe, saqë m'u duk se ai ende po kapsalliste sytë, si njeriu që nuk i beson pamjes që ka përpara.

-Eshtë nipi im, punon në radiotelevizion, - i tha, jo pa njëfarë krenarie, grupit të vogël, që duhej të ishin të njohurit e tij.

Nuk e doja xhaxhanë. Prej vitesh, sa herë që takoheshim, na qe bërë zakon të grindeshim, ngaqë kishim mendime të ndryshme për gjithçka. Për paaftësinë e kuadrove, për mungesat e tregut, për Stalinin, për programet televizive, për çështjen e Kosovës, etj.,etj. Nuk mbaja mend ndonjë gjë që të ishim në një mendje. Madje edhe për klimën, që shërbën zakonisht si neutralizuese e gjendjeve të acaruara, kishim mendime të ndryshme. Ai pëlqente klimën e nxeh të, kurse unë të ftohtën, gjë për të cilën ai s'mungonte të nxirrte një përfundim ideor: s'do mend, pëlqen klimën evropiane, se për çdo gjë andej e ke mendjen! E nga ta kem? i përgjigjesha unë, nga Bangladeshi, nga Azia? Skënderbeu luftoi një çerek shekull për ta shkëputur Shqipërinë nga Azia e për t'ia risjellë Evropës, kurse ju, ti me shokët e tu, ç'po bëni ju? Plasët që ta çoni prapë Shqipërinë andej!

Këtu zakonisht niste sherri për kinezët dhe gjithçka merrte rrrokopujën. Ai më quante mua liberal, revisionist, shkumëzonte nga tërbimi, kur e shihte se këto epitete s'më bënин ndonjë përshtypje, kërkonte më kot të tjera, më të hidhura dhe, ngaqë s'gjente dot, (sepse për të, ato ishin kulmi i akuzës), rikthehej prapë tek to. Revisionist, liberal i pandreqshëm... Kurse unë e quaja thjesht filokinez, i thoshja se, shyqyr që vendi s'kishte rrota se tani, kushedi ku do të ndodheshim, diku midis Gobit, ose Tibetit. Atje do ta ndjenin veten të sigurtë, padyshim, i thoshja. Larg Evropës së mallkuar.

Ishim grindur për kinezët gjatë kohës së miqësisë me ta, por jo më pak ishim grindur gjatë kohës së prishjes. Kur u pëshpërit për herë të parë për ftohjen, ai erdhi tek ne me një fytyrë disi të lodhur, të menduar. Për ca gjëra paske patur të drejtë ti, nipçë, më tha. Ata kinezët, s'paskëshin qenë ashtu siç hiqeshin. Dhe tamam atë ditë, që sipas gjithë gjasave duhej të ishte një ditë pajtimi, ndodhi dhe grindja më e ashpër. Ishte hera e parë që unë e quajta “tutkun” dhe që ai më kërcënoi me denoncim.

Në të vërtetë, sherri u hap prej meje, qysh në çastin kur ai shfaqi habinë e tij se, përse unë, kampion i urejtjes kundër kinezëve, nuk po

gëzohesha tani për prishjen me ta. I çuditshëm je, o nipçe, më tha, ters i madhe je! Ke kaq vite që bën gërr-mërr kundër kinezëve, dhe ja, tani që kjo punë po rregullohet, në vend që të gëzohesh, var buzët.

Mua më hipën xhindët. E pse të gëzohem, gati sa s'i ulërina. Kjo s'është për t'u gëzuar, po për të vënë kujën. Po ku kupton ti, more tutkun!

Dhe vazhdova t'i shfryj, se ne po prisheshim me kinezët, jo për shkak të të ligave të tyre, por përkundrazi, për faktin se ata po bëheshin gati të ndaheshin nga ato të liga. Kurse ne, na dhimbte zemra për to. Ne ishim bërë miq me ta, tamam për hir të atyre poshtërsive dhe tani që ata po i mohonin, ne po i kthenim krahet. Kjo ishte kujë, kujë e vërtetë. Dhe ne kështu kishim bërë gjithmonë. Ishim bërë miq me jugosllavët në periudhën e egërsisë së tyre më të madhe dhe ishim ndarë me ta, ditën e parë të zbutjes së tyre. Ishim bërë miq me sovjetikët në vitet e stalinizmit më të egër dhe ishim ftohur me ta, sapo kishin dhënë shenjën e parë të qytetërimit. E njëjtë gjë po ndodhë tani me kinezët. Të gjithë, njëri pas tjetrit, lodheshin, shkëputeshin më në fund nga e liga, nga zia. Kurse ne mbeteshim mbrojtësit e fundit të saj. Ne ishim bërë muze i së keqes, turp i dheut. A mund të gjendej një tjetër vend i tillë? Vend i mallkuar, tri herë i mallkuar.

Ai dëgjonte me sy të shqyer nga hutimi, urrejtja, frika. Dy-tri herë u mat të më ndërpriste, por goja, me sa dukej, i qe tharë. Vetëm kur unë thirra “vend i mallkuar”, arriti të thoshte: do të të denoncoj! Denoncomë, iu përgjigja, por mos harro, se hija do të bjerë edhe mbi ty!

Atëhere, siç ndodhë zakonisht në kësi rastesh, ai nxori kutinë e ilaçeve për të marrë një trinitrinë.

Kjo kishte qenë grindja jonë e parafundit. E fundit, mori shkas nga parrulla e Udhëheqësit: “Ne do t’i mbrojmë parimet e marksizëm – leninizmit, edhe sikur të detyrohemë të hamë bar”. Unë i thashë xhaxhait se nuk mund të mendohej parrullë, sa e pakuptimtë, aq dhe poshtëruese për dinjitetin e një populli. Ç’na qenkëshin këto parime, për hir të të cilave ne duhet të shndërroheshim në bagëti? E ç’do të na duheshin ato paskëtaj? Për lavdinë e bariut?

I zverdhur, me nofullën që i dridhej, ai s’dinte ç’të më përgjigjej. Hë, pra, fol, i thoshja unë. Përse na u dashkan këto parime që të shndërrokan në kafshë, si Circea? Ndërsa me vete mendoja: kushedi, mbështetur kjo është dëshira e fshehtë e tij, ulja e njeriut gjë te niveli i barngrënësit. Nënshtimi, idiotizimi. Dhe e gjithë kjo, në emër të parimeve të marksizmit. O Zot, ç’komedi!

E kupton ç’komedi ogurzezë është kjo? i thërrisja. Që bota e gjithë të gëzojë jetën, kurse ne

të sakrifikohemi në emër gjoja, të ca parimeve. E ç'punë ka populli shqiptar me parimet e marksizëm – leninizmit, nëqoftëse bota, sipas teje, i ka braktisur? Në emër të kujt ky popull i varfër, i sfilitur, duhet të mbetet mbrojtësi i fundit, i vetmuar i parimeve, që në fund të fundit, s'i ka nxjerrë vetë? Në emër të së ardhmes së botës? Domethënë, meqenëse parizienët, londinezët, vjenezët, etj., të verbuar nga mirëqenia, muzika e qejfi, paskëshin zënë udhën e gabuar, ne shqiptarët jemi gati të fljohemi, të hamë bar, për shpëtimin e tyre?

Ha, ha ha, ç'farsë makabre!

Mjaft, arri i më në fund të më ndërpriste ai. Ti je i prishur në themel, ndaj s'mund t'i kuptosh këto gjëra. Ti s'mund të kuptosh se, edhe sikur Shqipëria të shuhet nga faqja e dheut, s'ka gjë, mjafton që idetë e Udhëheqësit të saj të jetojnë!

Mbeta i shtangur nga ky formulim që e dëgjoja për herë të parë. (Më vonë e mora vesh se ishte thënë nga ministri i Brendshëm, në një mbledhje të fshehtë me kuadrot).

Shtangien time ai e mori, siç duket, për mbërthim me shpatulla për muri. Ndaj më vështroi ca sekonda me sy prej ngadhnjyesi, gjersa unë iu sula, këtë herë në mënyrën më të papritur për të.

Ti që flet kështu, ti i bën akuzën më të rendë Udhëheqësit, i thashë. Unë i bëj akuzë atij? qeshi ai.

Hm, e kush flet për Udhëheqësin. Ti, pikërisht ti, vazhdova unë. Vetë fakti që shtron alternativën, o Shqipëria, o Udhëheqësi, kjo është dhe akuza më e rëndë kundër tij. Domethënë, sipas teje, ose njëri, ose tjetri, përndryshe s'ka vend në botë për të dy. Me një fjälë, *mors tua vita mea*.

Unë s'thashë ashtu, klithi ai, mos i shtrembëro fjalët e mia. Ashtu the, thirra unë. E the fare qartë: të shuhet Shqipëria, që të jetojnë idetë e Udhëheqësit!

Dhe papritur, gjithçka u shurdhua brenda meje. Mos kjo ishte pikërisht dhe ëndrra e fshehtë e Udhëheqësit: të shuhet nga faqja e dheut Shqipëria, ky vend i bezdisshëm, me këtë popull të varfër që i vërtitej nëpër këmbë, që duhej ushqyer, qeverisur?! Kurse i shuar, i faruar, sa punë e pastër do të ishte. Vetë i vdekur, por i ringjallur në librat dhe idetë e prijsit. Dhe sa komode ishte e gjithë kjo: as realitet që të dëshmonte të kundërtën, as njolla, as dëshmi krimesh. Vetëm libra, ide, *lumiere*.

Unë s'thashë ashtu, vazhdonte të ulërinte ai. Ti je shtrembërues fjalësh, je djalli vetë.

Grindja jonë po i afrohej fundit, sipas rutinës së zakonshme: do të të denoncoj, denoncomë, vec hija do të bjerë edhe mbi ty, trinitrinat, etj., me të vetmin ndryshim, se këtë herë unë gjithashtu bërtisja: do të të denoncoj unë ty! Dhe jo vetëm

kaq, por i shtyrë nga një sarkazëm therëse, (kisha vënë re se ai më qetësonte, sidomos kur bënte efekt mbi xhaxhanë), vazhdoja: Do të të denoncoj, veç më vjen keq, se hija do të bjerë edhe mbi mua!

Këtu ai humbi çdo kontroll të vetvetes, kështu që fundi i grindjes sonë u shndërrua në një skenë me të vërtetë groteske, ku përziheshin denoncimet që ne do t'i bënim njëri-tjetrit, hijet që do të lëshonim mbi njëri-tjetrin me këtë rast, gjer te kutia e trinitrinave, prej të cilës, për habinë e tij dhe timen, unë gjithashtu rrëmbeva një kokërr dhe ika si i marrë.

Me siguri, ashtu sikurse mua, edhe xhaxhait i kujtoheshin në njëfarë mënyre të gjitha këto, sepse habia në sytë e tij sa vinte e zmadhohej. Me të bashkë, një farë ngadhnjimi: ja, më në fund erdhe edhe ti në binarë, o nipçë! Bëre sa bëre, po u fute në shtrungë.

-Kështu pra, të paskan dhënë ftesë, - tha duke më rënë krahëve. Urime, urime! Gëzohem shumë për ty!

Po të ishim diku mënjanë, do të më thoshte me siguri: dhe me mend në kokë tani, ë? Por edhe në s'm'i tha me gojë, gjithë qëndrimi i tij, vështrimi, rënia me dorë mbi supe alla-kinostudio “Shqipëria e re”, m'i kaluan ato fjalë, madje më fort.

Unë zgjata dorën për t'u ndarë me të, por ai tha gjithë gëzim:

-Ku vete? Rri këtu. Eshtë vend i mirë për të parë.

-Por unë...

Një ndjenjë mbrojtjeje e vetvetishme më shtynte të mos i thoshja se e kisha vendin në tribunë, por ngaqë u gjenda ngushtë, u detyrova t'ia tregoj.

Gjithë qëndrimi i tij ndryshoi në çast, sikur të mos shikonte në dorën time ftesën, po një lajmërim vdekjeje.

Ma mori, ose më saktë, ma rrëmbeu atë nga dora me një lëvizje të furishme, si një shpend grabitqar. Dhe po të tillë, mosbesues dhe grabitqarë, sytë e tij u ngulën te shkronjat, si të kërkonin atje gabimin e pafalshëm. E mbajti kështu një copë herë. M'u duk se duart po i dridheshin dhe balli iu mbush me djersë të ftohta. Fytyra, gjithë qenia e tij, bashkë me medaljet që m'u duk se tringëllinë kërcënueshëm, dukej sikur thoshnin: keqkuptim, keqkuptim! Ti në tribunë, ti me ato mendime të mbrapshta për kuadrot, për Stalinin, për qarkullimin monetar... Hijet e ligësisë e të dyshimit këmbenin njëra-tjetren në vështrimin e tij. Do të thoshje se, po t'i jepej mundësia, ishte gati të merrte në telefon instancat përkatëse për të bërë sqarimin, ose më saktë, denoncimin e nevojshëm. Nip e kam vërtet, por Partia mbi të gjitha!

-Ka ndonjë ngatërresë?-pyeti një nga shokët e tij me pamje babloku.

-Ah, jo, jo.

Xhaxhai ma zgjati më në fund ftesën. Fytyra e tij m'u duk befas, e flashkët dhe e lodhur jashtë mase. Pastaj, midis hutimit që gjithsesi nuk i davaritej, në vështrimin e tij mbiu një ndriçim djallëzor. Sytë e tij u zvogëluan e u zvogëluan, për t'u bërë sa më zhbirues. Ai m'i nguli ato me një përqendrim, që m'u duk i padurueshëm. Një ndjesi e beftë superioriteti e riorganizoi gjithçka në atë fytyrë, gjer në atë çast, të mjerë. Pyetja që i druhesha më shumë se çdo gjëje, u shfaq e pamëshirshme. Ç'ke bërë që ta dhanë atë ftesë? Dhe pastaj ironia: u mburre, sa u mburre, pastaj e pe se nuk bëhej ndryshe...

Tani ishte radha ime të mbythesha në djersë të ftohta.

Ne, që ti ke qejf të na kritikosh ditë e natë, ne së paku, i kemi marrë me ndershmëri ftesat, ashtu si çdo gjë tjetër. Ne ashtu mendojmë, siç flasim dhe këtu jemi në festën tonë. Po ti që mendon ndryshe, ç'kërkon këtu? Apo ndoshta smira që nuk arrije të njypeshë dot, të bënte që të shaje gjithçka? Dhe sa t'u dha rasti më i parë, harrove ç'ishe dhe shkele mbi çdo gjë, për të arritur atë që ëndërroje? Diçka të fortë paske bërë, nipçe, që jo vetëm na arrite, por na e kalove të gjithëve. Diçka shumë të fortë. Por s'ke ç'i bën, kështu janë këto punë. Tani duhet të ruhemti ne prej teje, nipçel!

Isha i sigurtë që pak a shumë, këto thoshte me vete, ndërsa unë kisha një dëshirë të çmendur të thërrisja: asgjë nga ato që mendon mendja jote e ndyrë s'kam bërë, o matuf! Përkundrazi, një orë e më parë isha gati ta këmbeja ftesën e tribunës, me një takim dashurie. Dhe me cilën pa... Por matuf siç ke qenë gjithë jetën ti, s'mund t'i kuqtoш kurrë këto!


Në dorë mbaja ftesën që ai porsa ma kishte kthyer, në kohën që po më thoshte:

-Ik tani, se t'u bë vonë!

Sytë e tij ishin të akullt dhe fjalët “ik tani, murtajë”, nuk mund të shqiptoheshin më urrejtshëm.

Në dreq të vesh, gërxho, hungërriva me vete. Rrangallë medaljesh. Dhe pa i dhënë as dorën, u largova prej tij.

Pas pak e gjeta veten duke ndjekur kolonën e imët të të ftuarve, që po ecnin drejt tribunave. Shikime anësore, fshehtane, ku smira, admirimi dhe mllefi, sajonin një si buzëqeshje, që po aq mirë mund ta quaje antibuzëqeshje, na përcillnin ngado. Ta kisha grisur më mirë atë ftesë dhe të mos shfaqesha më kurrë në këtë vend. Ç'më bëre, Suzi!



Dhimbja për humbjen e saj më gërrici egërsisht. Sa herë që kisha patur frikë se mos e humbja, ndërgjegja ime kështu e formulonte emrin e saj: Suzi. Ishte më i përshtatshëm për të të gërricur, ashtu siç qe më i përshtatshëm për të dhënë krenarinë e saj si vajzë udhëheqësi. Ç'më bëre Suzi, thashë prapë me vete. Ku e gjete këtë ditë për të ma dhënë këtë hidhërim?

Isha i sigurtë, se shumë kohë do të mjerohesha për të, veç atë ditë e kisha të padurueshme.

Ndërsa ecja kështu, me siguri mjaft i zympo, në krahasim me ngazëllimin që zotëronte përreth, disa hapa përparrë meje, dallova një profil të njojur. Ishte piktori Th.D., që me sa dukej, po shkonte gjithashtu drejt tribunës. Për dore, edhe ai mbante vajzën e tij të vogël. (Ku ishin vallë kordelja e kuqe dhe blu?)

U afrova që të ecja sa më pranë tij, i shtyrë siç dukej, nga ideja, se nën hijen e tij do të kaloja pa u vënë re. Veç kësaj, mund të përfitoja dhe unë diçka nga përligjia e pranisë së tij. Së paku, për të nuk mund të thoshnin se e kishte merituar ftesën me ndonjë shërbim banal.

Tek ecja, hetoja fytyrën e tij. Pas times ishte, me siguri, e vetmja fytyrë e ngrysur në këtë solemnitet. Kështu e kisha parë zakonisht në ceremonitë e ndryshme që transmetoheshin në TV. Siç duket, të drejtën për të qenë i ngrysur, e kishte fituar prej kohësh. Padyshim, diçka më e vlefshme se gjithë honoraret që merrte.

Nuk dija tjetër njeri në republikë që të quhej, edhe i privilegjuar, edhe i persekutuar njëkohësisht. Qëllonte që të konsiderohej kështu, gjatë të njëjtës bisedë pas darke, madje nga i njëjtë njeri. Sidoqoftë, edhe njëra palë, edhe tjetra, ishin të një mendjeje, se marrëdhëniet e tij me shtetin, mbeteshin një mister. Flitej për kritika dhe akuza të rënda të bëra kundër tij, nga ato që e thyejnë njeriun më dysh përjetë, por me përjashtim të një pleniumi, gjithçka kishte ndodhur në fshehtësi. Pas tyre, në kohën që pritej rënia e tij (do ta pësojë, ose nuk kanë ç’i bëjnë, ky ishte gjithashtu një diskutim, në të cilin njerëzit ndaheshin), ai shfaqej përsëri në ndonjë tribunë, me zymtinë e pandryshueshme në fytyrë.

Me çfarë çmimi e kishte blerë këtë? Sepse, ashtu si të gjithë ne, edhe ai kishte zhgabonjën e vet, më të tmerrshmen ndoshta prej të gjithave, që po e mbartte nëpër terr.

Bisedohej shumë për të nëpër kafenetë e sidomos, nëpër shtëpi, pas darkave. Flitej për xhelozinë që zgjonte në sfera tepër, tepër të larta, sidomos me ekspozitat e tij jashtë shtetit. Fliteshin shumë gjëra të tjera, por ajo për të cilën më së shumti ndaheshin njerëzit, ishte mendimi për rolin që ai mund të luante në jetën e sotme. Disa thoshnin se, me veprën e tij ai luante atë rol, të tjerë mendonin se jo. Më tepër, shumë më tepër pritej prej tij, ngulnin këmbë ata. Aq më tepër që ai e dinte se nuk mund t'i bën asnjë. Ai e dinte fare mirë se nuk mund t'i bën asnjë, atëherë, pse nuk e shfrytëzonte këtë?

Thua ti, se nuk mund t'i bëjnë asnjë, gjendej dikush që kundërshtonte. Haptazi s'i bëjnë dot gjë, jam në një mendje me ty. Po fshehtazi, prapa krahëve, kush mund të thotë se s'mund të ndodhë? Një aksident makine, një darkë ku ushqimi paskësh qenë i prishur, dhe të nesërmen, funerali madhështor dhe finita la comedia. Madje, do të thoshja se nervozizmi që shpërthen herë pas here kundër tij, pikërisht këtë ka për nëntekst: nuk po na falenderon që po të lëmë gjallë? Ç'kërkon më tepër?

Ah, ja, këto gjëra s'më kishin shkuar ndër mend, përgjigjej me sy të çakërritur tjetri.

Kështu flitej për të, por në çastin që po ecja pas tij, mua më interesonte vetëm fakti që asnjë s'mund të thoshte se e kishte fituar me ndonjë poshtërsi të rëndomtë ftesën. Verbtazi, vazhdoja t'i mbushja mendjen vetes se do të përfitoja edhe unë nga kjo, në rrugën gjer te tribuna, që më ngjante si një kalvar.

Ai takoi disa zyrtarë të lartë, (kështu dukeshin së paku nga veshja), të cilët, me radhë i përkëdhelën vajzën e vogël.

-Ky është shefi i shtypit, kurse ky, ministri i Jashtëm, - i tha ai vajzës, duke buzëqeshur në atë mënyrë, si të tregonte ca lodra. Ose ndoshta kështu m'u duk mua, ngaqë çdo frazë të tij e mendoja si të lëshuar nga një lartësi tallëse, prej nga ku ai, njeriu që qysh tani e dinte se ishte i pavdekshëm, kundronte përkohshmërinë e gjërave.

-Kush është më i rëndësishëm, ministri i Jashtëm, apo i Brendshëm? dëgjova ta pyeste vajza kur po largoheshin.

U afrova edhe më, që të kapja përgjigjen e tij.

-Hm, si të them. Gjërat e brendshme janë gjithmonë më të rëndësishme.

-Po të jashtmet janë më të bukura, - e kundërshtoi vajza.

Ai qeshi:

-E paske fjalën për fustanet. Ke të drejtë.

Ndodheshim fare pranë tribunës. Një kordon kontrolli, më serioz se gjithë të tjerët, po na priste.

Nxora ftesën dhe eca përpara. Nuk e di pse më dukej se kisha një uturimë në vesh.

-Pasaportën!

-Ah, po. Më falni!

Edhe disa metra dhe fillonte një hapësirë me tjetër klimë. Që këndeja, dalloheshin delegacionet e huaja, diplomatët që po kërkonin vendet e tyre, kamerat e TV.

E kalova me hap të lehtë hapësirën ndarëse dhe u gjenda atje. Kisha një shpërqendrim në lëvizje, me siguri në fytyrë, ose më saktë në buzëqeshjen që duhej të ishte sipër saj. Dikush më tregoi si kalohej në tribunën C-I, gjë që e harrova në çast, gjersa një tjetër ma ritregoi. Të ftuarit më preknin me supe nga të gjitha anët.

Me se ishin ngjitur gjer këtu? Njëherë m'u duk se kjo pyetje ishte në sytë e të gjithëve, por pak më vonë, pata përshtypjen se qe vetëm në kokën time. Një buzëqeshje e përgjithshme ngazëllimi, një farë salce bashkuese përpinqej të unifikonte e t'i jepte shije të përbashkët gjithçkaje. Ne jemi këtu tanët tani. Kemi bërë, ç'kemi bërë, s'ka rëndësi! Në fund të fundit, të gjithë një rrugë kemi ndjekur. Rrugën që

të sjell këtu. Pranë pushtetit, dritës hyjnore, Olimpit.

Dy sy të përqarë m'u duk se më panë me ligësi. Ndoshta nuk i shijonte lumturia, ngaqë më shikonte edhe mua aty. Ç'është ky i panjohur i rëndomtë në këtë vend të zgjedhurish? Ka kallëzuar, apo ka denonuar, dakord, megjithatë, është herët për ta sjellë gjer këtu. Të ishte ashtu, gjysma e Shqipërisë....

Por bezdia prej syve të ligj u davarit në çast. Përballe tribunës, orkestra vazhdonte marshet festive. Flamurthët fërgëllonin edhe më gjallërisht nga flladi, si të ndienin afrimin e orës dhjetë. Një grimë pashë përsëri Th.D., por e humba aty për aty. Ndoshta po shkonte më tutje. Në tribunën B, për të mos thënë në A.

# 8

Në kokën time vazhdonte po ai shpërqendrim i çuditshëm. Ishte me siguri, dehja që duhej të krijohej nga afërsia me pushtetin. Nuk ishin shpikur kot gjithë ato emblema e fanfara.

Me siguri, dehja do të ishte e plotë, sikur të mos më pengonte një shije funerali. Funerali i Suzanës. E kisha humbur Suzanën, për këtë tribunë. Dhe lulet, dhe muzika, dhe stofi i kuq solemn, mund t'i shkonin fare mirë mbarimit të saj. Flijimit.

Lutjet edhe thirrjet ndaj të atit  
As dhe moshë e saj virgjine s'preken  
Shefat e ndërkryer keq për luftë.

Gjithsesi, s'mund ta hiqja mendjen nga ato që kisha lexuar ato ditë për flijimin e vajzës së

Agamemnonit. Zhumhuri festiv rrreth e rrrotull, muzika dhe mëndafshi i kuq plot parrulla, në vend që të më laronin, më çonin edhe më pranë tij. Dymijë e tetëqind vjet më parë, ja kështu si sot, turma të mëdha, si ato që pak më parë ecnin drejt tribunave, lëviznin drejt altarit, të veshur ndoshta me stof të kuq.

Ku po shpejtoni kështu? Ç'po ndodh? Ende s'e ke marrë vesh? Thonë se do të flijojnë vajzën e Agamemnonit.

Vajzën e Agamemnonit?

Thashethemet kishin ditë që qarkullonin në Aulidën e mbushur me ushtarë. Era frynte vërtet pa pushim, deti shkumëzonte rrreth anijeve të ankoruara në breg, megjithatë, kishte plot njerëz që dëgjonin me mosbesim atë ç'ka flitej për vonesën e nisjes për në Trojë. Vërtet pengonte era, apo kishte ndonjë arsyе tjetër? Erë kishte patur edhe kur lundruam gjer këtu, madje më shumë. Nëse ka grindje midis shefave të ushtrisë, siç pëshpëritet andej-këndej, pse nuk e thonë haptas?

-Sa shkoi ora, ju lutem?

Isha kaq i hutuar, saqë, sikur njeriu që më pyeti për orën të më prekte për bërryli, siç bëhet shpesh në kësi rastesh, me siguri do të dridhesha. Dhe kushedi, ç'dyshime do të zgjoja!

M'u duk se dikush më buzëqeshte dhe me vete

thashë: e paskam humbur fare, s'po i njoh as njerëzit, gjersa e kuptova se ai po i qeshte tjetërkujt. Ishte një fytyrë e rreshkur, nga ato që u ngjasojnë fitqve të tharë. Nuk di ç'më tërhoqi vëmendjen te ajo fytyrë, rrudhat e së cilës mund t'i merrje edhe si nënqeshje mosbesuese, ironi, ose dije e diçkaje që zakonisht s'dihet. Po, ky është këshilltari i babait të Suzanës, thashë me vete. Ishte pikërisht ai. Kur një vit më parë kishte ardhur në një mbledhje në TV, më kujtohej që një shoku im më pëshpëriti: ky është këshilltari kryesor i shokut X.

E vërejta një copë here, me një vëmendje armiqësore. Dinte gjë vallë për ndryshimin e ardhshëm të Suzanës? Me siguri që dinte, përderisa qe këshilltari kryesor i të atit. Dhe jo vetëm kaq. Ndoshta ishte edhe ideatori i flijimit të saj. Kalkanti...

Mendja më shkoi prapë në portin e lashtë të Aulidës. Bregu i detit shungullonte paprerë dhe zdërhallja e ushtarëve buzë tij e shtonte frymën e çmobilizimit. Shumëkush ëndërronte heqjen dorë nga lufta dhe kthimin pranë gruas, ose të fejuarës. Kështu dhe nisi të pëshpëritej: fushata do të anullohej, kur befas, rrufe në të kthjellët, u hap lajmi tjetër: për të qetësuar erërat, Agamemnoni, kryekomandanti, do të flijonte vajzën e vet!

Shumica s'e besuan në fillim. S'e besuan

dashamirësit e shefit të flotës, ngaqë u erdhi keq për të. A ishte vallë i domosdoshëm një flijim i tillë? S'e besuan dashakeqasit, ngaqë s'donin ta pranonin se ai ishte i aftë për një akt të tillë vetëmohues. S'donin ta besonin më në fund ata, që mezi ç'prisnin anullimin e fushatës.

Jo, s'ishte e mundur një gjë e tillë. Ishte vërtet një marrëzi dhe për më tepër, e panevojshme. Sa për erën, detarët e vjetër thoshnin se s'ishte e tillë sa të përligjte këtë kob. Veç kësaj, ku ta dish se ajo do të shtrohej vërtet pas kësaj? Në fund të fundit, falltari Kalkant e kishte dhënë këshillën, por dihej që ai ishte njeri i dyshimtë.

Kërkova me sy këshilltarin e babait të Suzanës, por nuk e pashë gjëkund. Sikur ta gjeja, i përhënur siç isha, kishte rrezik ta pyesja: ti ia paske dhënë babait të saj atë këshillë të mbrapshtë? Po pse, pse?

Në librin e Grejvsit flitej gjerësisht për Kalkantin. Nga të dhënat e të vjetërve, figura e tij mbetej më enigmatikja. Dihej që ai ishte trojan, i dërguar enkas te grekët prej Priamat, për të sabotuar fushatën. Por ai u bë vërtet me grekët, pra përfundoi si renegat. Mirëpo s'kishte si të mos pyesje: ishte vërtet renegat, apo hiqej si i tillë? Më poshtë, siç ndodh shpesh në kësi rastesh, pas mëdyshjeve të shumta, në një luftë që ngjante pambarim, përfundoi në një agjent të dyfishtë?

Këshilla për flijimin e vajzës së Agamemnonit duhej të ishte një çast kyç në karrierën e tij. (S'duhej harruar se shortaritë e tij, si shortaritë e çdo renegati, dëgjoheshin me dyshim). Nëqoftëse ai kishte mbetur besnik i Priamit, ishte e qartë se e kërkoi flijimin e vajzës së shefit, për të shtuar grindjet dhe përçarjet midis grekërve, që edhe pa këtë, ishin jo të pakta. Nëse ishte bërë vërtet me grekët, atëherë dilte pyetja: besonte vërtet se flijimi i vajzës do t'i shtronte erërat, (apo diçka tjetër: pasionet, mosmarrëveshjet), duke lehtesar kështu nisjen e flotës?

Sido që të ishte, renegat i vërtetë ose kallp, intoksikator, ose agjent i dyfishtë, këshilla e tij ishte tepër e guximshme, për të mos thënë e çmendur. Një shortar, aq më tepër në rrethana të tillë delikate, duhej të kishte armiq të shumtë, që do të shfrytëzonin me zell çdo gafë të tij. Ishte padyshim, i humbur nga të gjitha anët.

Pra, ishte më tepër e besueshme që Kalkanti të mos kishte dhënë asnje këshillë, dhe Agamemnoni ta kishte menduar vetë atë flijim, për arsy që i dinte vetëm ai. S'kishte qenë e vështirë që emri i Kalkantit të shtohej më vonë në gjithë këtë histori (përligja e Agamemnonit përpala opinionit liberal për krimin, ngulmimi për të fshehur arsyen e vërtetë të tij). Kurse në çastin para nisjes së flotës,

kish mundësi të mos qe folur fare për erën, etj., etj., dhe flijimi të qe bërë pa dhënë asnijë shpjegim...

Ushtarakë, përzier me civilë aulidas, ecnin drejt vendit ku ishte ngritur altari. Për të shmangur rrëmujën, ndoshta ishin bërë edhe ftesa. Të gjithë kishin një pyetje në gojë: ç'ishte ky flijim? Përse? Ndihej menjëherë se mungesa e shpjegimit, e shtonte peshën e ankthit.

Jo, asnijë këshillë s'kishte dhënë Kalkanti. E dyshimtë do të dukej çdo fatthënie e tij djallëzore. Atëherë, përse Agamemnonit i kishte shkrepur në kokë flijimi i vajzës?

Në tribunë bëhej një lëvizje e qetë, e përhershme, e të ftuarve që kërkonin të zinin vend, atje ku mendonin se do ta shihnin më mirë parakalimin, ose tribunën e mesit, ku do të dilte udhëhecja.

Isha duke bërë edhe unë të njëjtën zhvendosje, kur e pashë Suzanën. Ishte në C-2, pak më poshtë se ne, midis një grupi të vogël, të gjithë djem e vajza zyrtarësh të lartë.

Pak e zbehtë, me një mospërfillje që i spikaste herë në profil, herë në vezullimin e një karfice mbi flokët e rëndë, vështronte diku përpara, në drejtim të orkestrës.

Përse duan të të fliojnë, Suzanë, thirra me vete vajtimthi, qetësisht.

Ç’erëra duhet të shtrosh?

Ca çaste e ndjeva veten krejtësisht të zbrazët. Dhe midis zbrazëtisë kapitëse, i lodhur nga të gjitha këto, pyeta veten: mos e kisha tepruar me këtë analogji? Mos e gjithë kjo s’ishte veçse një gjë fare e thjeshtë, një korrigjim sjelljeje përpara fejesës, gjë që e bën shumë vajza? Dhe këtij ndryshimi banal, mendja ime e çakërdisur i kishte dhënë përmasa tragjike?

I nisur nga fjala “flijim”, i isha qepur një analogjie, duke e çuar në tendosjen më të skajshme të saj, ashtu si ata poetët e rind, që pasi krijonin përdhunshëm një figurë poetike, dashuroheshin kaq shumë pas saj, saqë shtresa-shtresa ngrinin mbi të një pjesë të tërë letrareske, por që i kishte themelët në rërë.

Nuk e kisha menduar kurrsesi, që ngjashmëria e beftë midis Suzanës dhe Ifigjenisë, një nga ato shkrepëtima të shpejta, flakëruese e kalimtare, nga të cilat truri njerëzor pëershohet mijëra herë në ditë, do të rritej në mendjen time, gjer në njëjtësim të plotë. Njëjtësimi ishte i tillë, saqë sikur të dëgjoja diku në radio, TV, apo teatër, fraza të tilla, si “Suzana, vajza e Agamemnonit, etj.,etj.”, do të më dukej kjo mëse e natyrshme. Ishte ky njëjtësim që më bënte, që gjithë kuadrin tjetër të dramës antike, ta përftoja të lidhur me Suzanën dhe të atin e saj.

Raportet Agamemnon-prijës të tjerë, grindje për pushtet, forcim pozite në udhëheqje, arsyё shtetërore, vendosje e disiplinës së hekurt, terrorit...

Njëfarë kohe, si të kërkonte të shkarkohej sa më parë nga një ngarkesë torturuese, truri im nisi të punonte vetëm në njërin drejtim, në atë të zhëdramatizimit të gjithçkaje. Pastaj befas, mekanizmi ngeci në vend, kërcëlliti mundimshëm dhe nisi të kthehej mbrapsht. Një “jo” e qetë, por e gjerë, e sundoi gjithë qenien time.

Jo, s'mund të ishte kaq e thjeshtë. Isha i lodhur, isha i turbullt, megjithatë, e ndieja se e gjithë kjo s'ishte kaq e thjeshtë. S'ishte as fjala “flijim” dhe, as libri i Grejvsit që ma kishin mbjellë në trurin tim atë analogji. Ishte diçka tjetër, që mjegulla ende s'më linte ta zbulojta, por që e ndieja se ishte aty pranë. Duhej të ishte aty, mu në sytë e të gjithëve, mjaftonte që të zgjoheshë një grimë nga dremitja për ta dalluar... Stalini, a nuk e fliroi birin e vet Jakovin për... për... të patur të drejtën... të thoshte se djali i tij... duhej të kishte... të kishte... fatin... fatin... fatin ... e çdo ushtari rus. Po Agamemnoni, ç'kishte kërkuar dymijë e tetëqind vjet më parë? Dhe ç'kërkonte sot babai i Suzanës?

Profili i saj që u valëvit diku midis dy supeve, ma shkëputi fillin e mendimit. Nuk di pse m'u kujtua takimi ynë i parë. Portret vajze, me një curril

gjaku... Kështu ishte stampuar në ndërgjegjen time... Ishte mbasdite fundvjeshte. Pas përqafimit të parë në kanape, ajo më kishte vështruar një copë here të gjatë në sy dhe ma kishte thënë qetësisht: unë ju dua! Pastaj vijoi të më shikonte në po atë mënyrë pyetëse, si të donte të merrte vesh se, a e kisha kuptuar. Nuk priste prej meje, veçse një shenjë për të vërtetuar atë që thoshte, dhe kur unë, pakëz i hutuar nga parandjenja e një fitoreje tepër të lehtë, i thashë me zë të pasigurtë, megjithatë: a shtrihemi? Ajo u ngrit në çast, dhe, me po atë qetësi që kishte folur, nisi të zhvishej.

Ndiqja me sy lëvizjet e saj të përbajtura, dantellat e të brendshmeve që u shfaqën pas heqjes së fustanit, këmbët e bardha pas heqjes së çorapeve, pastaj u ngrita nga kanapeja, e përqafova me kujdes, si të ishte një somnambul që mund ta zgjoja, ndërsa një grusht flokësh, ia shtrëngova fort pas faqes sime të djathtë. Më pëlqejnë femrat luksoze, i thashë me zë të ulët, pa e ditur, as atëherë, as më vonë, nëse fjala “luksoze” i përkiste të brendshmeve të saj perëndimore, karficsës së shtrenjtë që mbante në flokë, apo mënyrës së çlirët të dorëzimit.

Në kanape, pa më të voglin kundërshtim, i hoqi mbathjet e lehta dhe vërtet gjithçka do të ishte si në një akuarel dremitjeje, sikur befas, diçka e dridhshme, tokësore, të mos futej rëndshëm midis

nesh. Një mundim, një trysni që nuk i shkonte aspak lehtësisë së gjerathershme dhe që ajo u përpoq më kot ta fshihte, u ndie më në fund qartë.

-Çfarë Suzanë?- pyeta midis dihatjes.

Ajo nuk u përgjigj. Veç ndjeva ngërçin, i cili që nga qendra e trupit i shpërndahej kudo dhe diçka kuptova. Megjithatë, habia ime qe e madhe kur ajo me zë të çngjyrosur tha: isha vajzë!

Ndenjëm gjatë në kanape pa folur, gjersa ajo me buzëqeshje, që më tepër mund ta quaje një përndritje sipër mollëzave, tha: "Ishte e bezdisshme, apo jo?"

S'dija ç't'i përgjigjesha dhe ajo vazhdoi: Prandaj nuk ju thashë asgjë në fillim.

Isha i paaftë të thoshja diçka, ndoshta ngaqë lumturia më qe shfaqur në formën e saj më të sigurtë, e mbështjellë me një vello trishtimi. Fitorja që disa caste më parë më qe dukur aq e lehtë, tani po më ngjante nga më të vështirat. Mos më merr në qafë, Suzanë, u luta me vete.

# 9

Ndërprerja e orkestrës dhe një gërgamë mikrofonësh, e pasuar nga stuhia e brohoritjeve, shkaktuan kthimin e kokave drejt tribunës qendrore. Po dilte udhëheqja. Që nga vendi ku isha, mund të dalloja vetëm një pjesë të tyre. Nuk e shihja dot Udhëheqësin dhe as babanë e Suzanës, që ndoshta i rrinte përbri. Nga C-I duke shin qartë vetëm katër koka. Ishin vërtet të mëdha, apo m'u duk ashtu, ngaqë m'u kujtua epiteti “kokëtrashë”, që një shoku ynë nga redaksia e muzikës, flitej se kishte përdorur për ta? E kishin dërguar me dënim në minierë, ngaqë kishte bërë pyetjen se, përse në një vend me dyzet vjet socializëm, duhej që shumica e anëtarëve të Byrosë Politike, të zgjidheshin midis njerëzve të paarsimuar? Kështu thuhet se kishte folur në një darkë. Madje disa, këmbëngulnir se

kishte shkuar dhe më tej. Njëqind vjet më parë, qeveria shqiptare e Lidhjes së Prizrenit kishte qenë më e kulturuar se e sotmja. Kështu paskësh thënë, por në mbledhjen e përjashtimit, s'u përmend asgjë nga këto. Siç duket, ashtu si në rastin tonë, qenë quajtur tepër të rrezikshme për t'i zënë në gojë, qoftë edhe si fjalë të mallkuara. Dhe tamam si në rastin tonë, iu ngriten ca të meta në punë, mendime liberale për muzikën perëndimore dhe tallje me punën në prodhim.

Fitorja më e madhe e Partisë, njeriu ynë i ri... Kjo fitore e ndritur... Vendi më i lumtur në botë... pa kredi, pa taksa.... I vetmi vend socialist...

Copëra të fjalimit të hapjes më kalonin si përherë anash veshëve, të përsëritura, të mërzitshme gjer në vdekje, pa shërim, pa shpresë. Si në një teatër hijesh, qëllonte që pas formulave më shfaqeshin fytyra të njojurish, të dënuar pikërisht për shkak të tyre. Dhe përgjithësisht, po të ktheje sytë përreth, do të ndeshje me parrulla, pamje, ose portrete, që ishin bërë shkas për dënimë njerëzish. Kushtetuta që ndalonte marrjen e kredive nga jashtë, begatia (domethënë mungesa) e mishit, dekadenti Sartr, forma e syve të Mao Ce Dunit.

Shoku ynë nga redaksia e muzikës, pati megjithatë, më shumë fat se një djalë nga teknika, që kishte folur diçka për privilegjet e udhëheqësve

e të fëmijëve të tyre, vilat, udhëtimet jashtë. Atij gjithashtu nuk iu përmendën këto, por gjëra krejtësisht të tjera, ca mendime të tij për dashurinë e lirë, (kjo, sa për përjashtim nga puna), pastaj ishte biseda e tij me një turist të huaj që e rrënoi përfundimisht. Dhe sikur të mos mjaftonte kjo, u fol se gjatë hetimeve, jo vetëm që pranoi ç'kishte thënë për "oborrin", por kishte shfyrë sa kish mundur. Kishte folur për transferim ari e diamantesh në banka të huaja, njëlloj si në kohën e mbretërisë, për vrasje pas shpine e për kobe të tjera. S'kishte kursyer askënd, as vetë Udhëheqësin, por sidomos të shoqen e tij, që e kishte quajtur frymëzuese kryesore të krimeve, një Ledi Makbeth të vërtetë, veçse një Ledi Makbeth maloke, Çian Çin i Shqipërisë, etj.,etj.

E dënuan me pesëmbëdhjetë vjet burg, por nuk arriti të bënte as çerekun... Në minierat e kromit flitej për hone të thella, ku të burgosurit ordinerë shtynin si rastësisht, politikët. Dhe kështu, me një rënie, në të cilën dendësohej mizorisht në pak sekonda, rënia e ngadaltë, stinë pas stine, e vit pas viti e njeriut, merrte fund gjithçka.

Privilegjet e udhëheqësve e sidomos të fëmijëve, ishin një nga motivet e përhershme të debateve të mia me xhaxhanë. Veçse këtu, ai nuk tërbohej si për të tjerat. Me sa dukej, diçka nuk i

pëlqente dhe atij vetë, pavarësisht se s'donte ta pranonte. Polemika ime me xhaxhanë për këtë subjekt, mori fund kur njoha Suzanën. Ajo më befasoi. Ishin të paqena ato që fliteshin, apo Suzana ndryshonte nga të tjerat? Shpejt e kuptova se ishte kjo e dyta. Suzana ndryshonte vërtet në gjithçka.

Prandaj të zgjodhën ty për të të fliuar, mendova. Dhe aty për aty, si një dallgë e beftë më goditi mendimi: po sikur flijimi të ishte kallp! Sikur Suzana të hiqej për sytë e botës si vajzë e thjeshtë, modeste, kurse atje, brenda lagjes së tyre, në vilat dhe plazhet e rezervuar, të bënte jetën e luksit, me kërcime, pijë dhe seks?

Ndjenja e xhelozisë më gjerrici si brisk. A s'kisha lexuar pandehmën për flijimin kallp të vajzës së Agamemnonit? Në altar, në çastin e fundit, në vend të saj, vendosja e një drenusheje etj.,etj. Pra, spektakël klasik për t'i hedhur hi syve turmës. Zgjidhje tipike e problemit nga çdo sundimtar. Suzana ime, në vila plazhesh dimërore, duke kërcyer si e çmendur, duke u zhveshur kanapeve, duke rënkuar... Jo, më mirë e fliuar, e mbaruar.

E kisha regjistruar një mbasditë në magnetofon rënkinin e saj dhe natën vonë, kur të gjithë flinin, u mbylla në kuzhinën e apartamentit për ta dëgjuar. Ishte gjithsesi e çuditshme ta dëgjoja kështu rënkinin, të veçuar nga akti, nga pamja e saj. Ishte i

një trajtshëm, poroz, gjithë frysë dhe hapësirë. Zhurmat e rrugës, ndonjë vërvshëllimë, ndonjë buri e largët makine, të futura midis, i jepnin një përmasë kozmike, si natës së verës meteoritet e skajshëm aty-këtu.

E ktheva kasetën disa herë dhe ndjesia e përhumbjes kozmike, në vend që të dobësohej, zotëronte më fort. Më dukej vetja larg, i ndarë prej saj. Herë më ngjante se ajo ishte nën tokë dhe unë, që sipër varrit dëgjoja mundimin e saj, herë sikur unë isha i varrosuri, dhe që përmes baltës, bashkë me zallahinë e epokës, ia kapja pshërëtimën.

Një herë e ngrita volumin e zërit në maksimum, si të doja të mbushja gjithë botën me atë frysëmarrje dhe në atë çast, m'u kujtua se përveç pubisit të zi, ende nuk ia kisha parë seksin, burimin e vërtetë të gjithë atij gjëmimi.

Në takimin tjetër, serioze, si në gjithçka që lidhej me dashurinë, ajo qëndroi në atë mënyrë, që poshtë kaçubes së pubisit, t'i dukeshin buzët rozë të zbehtë të seksit. Për disa sekonda rresht, e vështrova me një farë habie seksin e saj dhe në sy duhej të kisha pak a shumë befasimin e njeriut që, pasi ka dëgjuar një hungërimë të fuqishme, papritur zbulon se pas kaçubes, pas së cilës duhej të fshihej bisha, nuk ishte veçse një gjëkafshëz e vogël, disi e rëndomtë.

Në të vërtetë, sekzi i saj ashtu m'u duk, i thjeshtë, në krahasim me pasurinë e natyrës së saj komplekse. Padashur bëra krahasimin me seksin e ish-të fejuarës sime. I rëndë, barok, do të thoshja, një mekanizëm i ndërlikuar i dashurisë. Por ndoshta, edhe ai s'kishte qenë në fillim ashtu, por qe bërë me kalimin e kohës, pas përdorimit të shumtë... Currila të tëra sperme kishin kaluar përmes tij... Dhe jo vetëm nga e imja. Para meje ajo kishte patur marrëdhënie me dy të tjera, dhe ishte ndoshta enigma e tyre që ia rriste peshën në sytë e mi. Kurse Suzana ishte në fillimet e saj. Ndoshta më vonë, edhe sekzi i saj do të ndërlikohej nga misteri... Më vonë, kur unë të mos e shijoja më.

Gjëmimi i papritur i orkestrës më bëri të dridhem. Kishte nisur parakalimi.

Ishte po ajo rutinë e përvitshme që e kishim parë kaq herë në TV. Fiskulturistët me flamurët mbi shtizat e gjata, tufat me lule dhe kurorat, me të cilat bënин figura gjimnastikore në ecje e sipër. Kuadrate të tjera të shumëngjyrtë djemsh e vajzash sportiste. Me siguri, pas tyre do të vinin vargani i ndërmarrjeve të ndryshme, në krye si përherë metalurgët, pastaj me radhë minatorët, tekstilistët, punonjësit e tregtisë, të kulturës; lagjes, shkollat, uf... Në një lëkundje të ngrirë sipër kokave të tyre, dukeshin portretet e mëdhenj të anëtarëve të Byrosë Politike. Vështrimi im ndiqte vetëm njërin portret, atë të babait të Suzanës. Përse ia kishte kërkuar së bijës ndryshimin e veshjes e të sjelljes? Ç’mesazh ishte ky? Ç’simbol?

Të ishte një masë e ndërmarrë nga frika, (nëqoftëse ai do të ishte në rënien), kjo qe plotësisht e kuptueshme. Por ai, jo vetëm që s'ishte në rënien, por përkundrazi, po ngrihej çdo ditë. Dhe ishte pikërisht ngritja që e kishte pjellë, madje i kishte dhënë peshën e fjalës “flijim”, ndryshimit të ardhshëm të Suzanës.

Portreti i tij ishte tani fare pranë tribunës. Për të dhjetën herë, unë i thirra së brendshmi: ç'shenjë është kjo?

Fushata e tmerrshme kundër liberalizmit në kulturë disa vite më parë, kështu kishte nisur, gati në mënyrë të pavërejtshme. Një letër e ardhur nga rrathi i Lushnjes, me vërejtje për fustanin e spikeres së festivalit të këngës në radiotelevizion. Nga redaksia e muzikës, letra, e shoqëruar me buzëqeshje dhe komente ironike, kishte kaluar te njëri nga nëndrejtoret e radios. (Ju paska bërë përshtypje të keqë fustani pakëz i gjatë i spikeres. Eh, të mbetur prapa kohe, s'ke ç'i thua! Ç'do gjë e kuptojnë së prapthi. S'i merr dot as inat, veç në mos qofshin spekulantë). Nëndrejtori, me pak a shumë të njëjtin humor, më tepër për kureshti se sa seriozisht, ia kishte treguar drejtorit të radios. Ky i fundit, i trembshëm siç qe prej natyre, nuk kishte qeshur, por as e kishte bërë problem. Kishte thënë vetëm: duhet patur kujdes me kësi gjërash, nganjëherë të

pjell belaja, fjalë që e kishin ftohur në çast nëndrejtorin. Dhe vetëm dy ditë më pas, kur po pinin bashkarisht kafenë me drejtorin e përgjithshëm të radios e të televizionit, ose “shefin e madh”, siç e thërrisin, dhe ky i fundit, përmes një gazi të bujshëm, kishte pyetur për “letrën e famshme nga Lushnja”, nëndrejtori qe çliruar plotësisht.

Kishin qeshur bashkarisht atje te tryeza e bufesë, ai, drejtori i TV, sekretari i Byrosë së Partisë dhe vetë i trembshmi drejtori i radios.

Por shumë shpejt ajo e qeshur u doli për hundësh. Një javë më pas, pikërisht për atë letër, drejtorin e përgjithshëm e morën në telefon nga aparati i Komitetit Qendror. E kishin pyetur, përsë nuk i qe dhënë përgjigje letrës. Drejtori kishte kundërshtuar. S'ishte detyrë e radiotelevizionit t'i jepte përgjigje çdo letre e aq më tepër, çdo budallallëku.

Të gjithë ata që e kishin dëgjuar ngjarjen, madje edhe shefat më të vegjël, që nuk shkonin mirë me shefin e madh, dhe që do t'u pëlqente një tërheqje veshi ndaj tij, ishin në një mendje, se ai kishte të drejtë në këtë rast dhe se, në të vërtetë, si shumë po abuzohej me ato letrat nga populli.

Por pas disa ditësh, drejtorin e përgjithshëm e thirrën në aparat të K.Q., prej nga u kthyte me fytyrë

disi të zyrtë. Po atë mbasdite u bë një mbledhje, ku sekretari i Byrosë së Partisë foli për vëmendjen që duhej treguar për vërejtjet që vinin nga poshtë, duke bërë një autokritikë edhe për veten. Pas tij, foli fare shkurt edhe drejtori i përgjithshëm, i cili, pasi theksoi se sa i dëmshëm ishte nënveftësimi i vërejtjeve nga poshtë, bëri (gjë e pabesueshme), autokritikë për letrën e ardhur nga Lushnja.

Të gjithëve ne, punonjësve të radiotelevizionit, na u duk e tepruar një gjë e tillë. Pas mbarimit të mbledhjes dhe disa ditë më pas, shumë herë u diskutua, nëse ishte e nevojshme, ose jo, të prekej ashtu autoriteti i drejtorit të përgjithshëm, për një vocërrimë të tillë. Pothuajse të gjithë ishim në një mendje, se nuk duhej. Aq më tepër që ai ishte anëtar i K.Q. dhe se në këtë rast, në fund të fundit, s'kishte mbrojtur veçse interesin e institucionit.

Por duhet thënë se, krahas pezmatimit, të gjithë ne (duke përfshirë me siguri edhe vetë drejtorin), provuam një ndjesi lehtësimi. Ja, më në fund u plotësua edhe teka e dikujt, (kështu na dukej të gjithëve kjo këmbëngulje) për t'ia ulur pakëz hundën drejtorit. Dy-tri fjalë të përgjithshme, të ngjashme me parrullat e shkruara nëpër mure, (të mësojmë gjithmonë nga populli, të jemi të thjeshtë, etj.,) dhe çdo gjë kalon. Autokritika ishte vërtet një ilaq çudibërës.

Askujt nuk i shkonte ndërmend, se po gabonim në mënyrën më të trashë. Një javë më pas, pas mbledhjes së Partisë, ku thuhej se drejtori, bashkë me shefat e tjerë, kishin bërë prapë autokritikë, këtë herë serioze e të rëndësishme, u lajmëruam për një mbledhje të kolektivit. (A thua të jetë prapë për këtë? S'e besoj, kurrsesi! Si mund të zgjatet akoma kjo çështje dhe aq më tepër, në kolektiv?!)

Mbledhja ishte pikërisht për atë që dyshohej. Një i dërguar nga K.Q. ndiqte me sy zhbirues njerëzit. Si shumë përciptazi e keni kaluar këtë çështje, shokë. Jeni kënaqur me ca autokritika të cekëta, pa u thelluar të zbuloni shkaqet e së keqes, rrënjet. Por Partia nuk gabohet lehtë!

Sytë e drejtorit të përgjithshëm ishin të lodhur. Të lodhura ishin dhe fytyrat e të tjerëve. Dhe ky nuk ishte veçse fillimi i serisë së mbledhjeve, nëpër të cilat ne do të kalonim të gjithë si në një kalvar, për të dalë që andej të ndryshuar, plot thyerje, cikatrise dhe njolla në ndërgjegje.

Dukeshin të largëta, si nga një tjetër epokë, arsyetimet tonë të fillimit për ruajtjen e autoritetit të drejtorit të përgjithshëm, frika se mos fyhej, etj.,etj. Tani bëhej fjalë për tjetër gjë: kush mund të shpëtonte nga rrebeshi që nxinte kudo. Çdo ditë që vinte, sillte ndryshime të befta në mendësinë dhe

psiqikën tonë. Ajo që dukej e palogjikshme, e pabesueshme dhe e pamundur dje, bëhej e tillë nesër, për të synuar të pasnesërmen, drejt një kufiri më të frikshëm.

I pari që e pësoi ishte drejtori i radios. Kishte kujtar se do të lehtësonte veten, duke përmendur faktin se kishte patur një shqetësim për letrën e Lushnjës, duke thënë: (gjë që ishte e vërtetë), “duhet patur kujdes me këto gjëra, nganjëherë të pjell belaja”, por ishte pikërisht kjo që e mori në qafë. Kur e pate këtë shqetësim, përse nuk e bëre problem? Për të mos i prishur qejfin drejtorit të përgjithshëm? Për servilizëm, apo për diçka më të keqe? Fol, shok, thellahu! Ti je më i irrezikshëm se indiferentët. Ti e shikon të keqen dhe mbyll sytë!

Pas dërgimit, në fillim në fshat e pastaj në minierë, të drejtorit të radios, shumica kujtuan se viktima, më në fund u gjet dhe furia e rrebeshit do të binte. Por nuk ndodhi ashtu. Seria e mbledhjeve vazhdoi me po atë ritëm katastrofik të rrënimit të gjithçkaje. Më e tmerrshme se çdo gjë, ishte pranimi prej psiqikës sonë, i asaj që gjér dje dukej ogurzezë. Midis gropës hapej një brimë e re, dhe secili mendonte: oh, jo gjer këtu, ka një kufi çdo gjë, kjo është vërtet llahtarë! Por të nesërmen, llahtara zinte vend në rendin e gjërave dhe s’i bënte më përshtypje askujt. Madje më keq: ndërgjegjet e dobësuara

përpinqeshin të gjenin një farë përligjjeje për të.

Ne e ndienim se si çdo ditë tërhiqeshim fatalisht në mekanizmin e fajit të përbashkët. Duhej të flisnim, të akuzonim, të hidhним baltë, në fillim mbi vete, pastaj mbi të tjerët. Mekanizmi ishte vërtet djallëzor: pasi përdhosje veten, e kishe më lehtë të përbaltje gjithçka. Çdo ditë dhe çdo orë, vlerat morale zbeheshin. Një dehje e ligë po i kaplonte njerëzit: deliri i rrëzimit, i përlyerjes me llum. Shitmë, vëlla, s'më vjen keq, unë të kam shitur kaq herë gjer më sot! Dhe litari i fajit të ndërsjelltë, vijonte t'i lidhët të gjithë.

Në pamje të parë, ngjante se e gjithë kjo s'ishte veçse një makinë urrejtjeje, e vënë në lëvizje nga ligësia, karrierizmi, larja e llogarive. Por po ta shikoje më thellë, ajo ishte më e ndërlikuar. Si minerali i përzier me gjithfarë gurësh të tjerë, ashtu qenë përzier ato që dukeshin të papërzieshme: egërsia, mëshira, pendimi, gjëzimi i sëmurë që t'i mbeste jashtë goditjes, frika bestyde se do ta lash atë gjëzim. Ndjenjën e fatalizmit e të humbjes së drejtpeshimit shpirtëror, e shtonte mungesa e rregullsisë. Goditeshin ata që kishin qëndruar mënjanë histerisë, të shoqëruar me një keqardhje, por të çuditshme, në formë mllefë, (të zestë, ndonëse mirë iu bë, kujtuan se do të shpëtonin paq!) Goditeshin befas histerikët, ata që kishin ulëritur

më fort kundër të kritikuarve, që kishin kërkuar dënimet më të pamëshirshme për ta; dhe goditja e tyre ndiqej nga një valë kënaqësie (mirë iu bë, në këtë botë lahen të gjitha!) E pësonin ata që ishin treguar kokëfortë e s'kishin bërë autokritikë qysh në fillim, por gjithaq, në mos më keq, rrokulliseshin ata që kishin bërë autokritikë, e që qenë ngutur të jepnin material kundër vvetes.

Nuk kuptohej si ishte më mirë: të tulateshe diku, apo të kreshpëroheshe, të ishe personalitet i njojur, apo njeri i rëndomtë, me parti, apo pa parti! Si në një tërmet, njerëzit vraponin për të kërkuar një strehë të sigurtë, por streha që pak më parë ngjante e tillë, pas një çasti kthehej në të kundërtën. Gjithçka lëvizte, zhvendosej, dhe kjo paqëndrueshmëri pasqyrohej në mendimet dhe psikozën e njerëzve. Çorodiste idetë, shpërndante çdo pasion kundërshtimi e aq më pak, revolte. Askush nuk pyeste: ç'është kjo që po ndodh, pse? Dhe as që mund të mendohej për një zemërim ndaj saj, ashtu siç nuk përftohej dot zemërimi ndaj bubullimës.

Ishte e llogaritur vallë, që makina të vepronë kështu, sipas parimit të shtjellës së rrëmuishme, sipër së cilës, i paprekshëm si Fatumi vetë, ngrihej shteti, apo një rastësi misterioze e bënte të përkryer funksionimin e saj? Me sa dukej, befasia e goditjes,

mosparashikimi i drejtimit prej nga do të vinte rrufeja, e sidomos, zgjedhja e verbër e viktimës, ngjallnin bashkë me tmerrin, një admirim molisës ndaj shtetit.

Të ligështuar, me shpirtëra të squllur, ne kalonim nga mbledhja në mbledhje, përherë e më të rrënuar. Një shok që kishte punuar në hetuesi, më kishte thënë se një molisje e tillë krijohej në vetminë e qelisë, sidomos në fazën e parë të hetimeve. Me sa dukej, ndonëse përjashta e midis trupave të zhurmshëm, ne ishim po aq të vetmuar sa në një qeli. Në mos më tepër.

E largët, e pabesueshme, si dritëza që paralajmëroi dikur gjëmën, ngjante tani letra nga Lushnja. Ku ndodhej vallë, në ç'sirtare arkivash, a muzeumesh? Dhe fustani pakëz i gjatë i spikeres, ai që ndolli atë letër fatale, në ç'garderobë fshihej tani?

Sikur të thoshte dikush atëherë, se ajo letër me të cilën drejtori i përgjithshëm ishte tallur gjatë pirjes së kafesë atë mëngjes, njëqind vjet më parë, do të sillte një ditë shkarkimin e tij, të gjithë do të shqyheshin gazit. Por ja, erdhi ora që edhe ajo fjalë u tha. Dhe askush nuk u çudit. Madje një ndjesi lehtësimi sikur i kaploi të gjithë. Më në fund, e kecja plasi. Do të qetësoheshin më në fund të gjithë, do të qetësohej edhe ai vetë, ndëshkim më i ashpër as që mund të pritej për një anëtar të Komitetit

Qendor: transferim në qytetin e vogël N., drejtor i komunales. E megjithatë, s'është dhe aq keq, dëgjohej ndonjë zë. Një veturë e ka, të vjetër vërtet, por sidoqoftë veturë. Në fund të fundit, njëqind herë më mirë kjo, se ai ankth sfilitës.

Mund të mendohej vërtet kështu, aq më tepër që rrebeshi, pasi qe larguar njëfarësoj nga radiotelevizioni, po shfrynte me tërë furinë e tij mbi të gjitha institucionet e kulturës. Thuhej se kudo ishin bërë gabime liberale: në botime, në kinematografi, në Lidhjen e Shkrimtarëve e të Artistëve.

## 11

Fanfara e orkestrës më kushtëzonte ritmin e mendimeve të mia. Një farë kohe më qe dukur se ajo kishte heshtur, për të buçitur prapë më fort. Por ajo s'kishte pushuar asnjëherë. Ishte vetëm ndjesia ime, e shkaktuar ndoshta, ngaqë i përpire siç isha, nga rikujtimi i asaj që kishte ndodhur në radiotelevizion, pa e ditur as vetë në ç'mënyrë, e kisha thithur atë muzikë, për ta çuar atje, në ato ngjarje, që të shoqëroja si me një fanfarë antifestive atë ethe të çmendur.

Vorbulla thithte në shtjellën e saj, njëri pas tjetrit shkrimtarë, ministra, idera të shpallura djathtiste, filma, nëpunës të lartë, pjesë teatrale. Midis rrëmujës zhurmëtare, u përmend për herë të parë shprehja: “deviation i djathtë në kulturë” dhe fill pas saj, fjalët akoma më të tmerrshme: “grup antiparti”.

Në sfondin e asaj që po ndodhët në kryeqytet, kushtet e ish-drejtorit të përgjithshëm të radiotelevizionit në qytetin e vogël N., ato kushte që ishin quajtur prej shumëkujt poshtëruesse, dukeshin tani idilike. Punë me bojaxhijtë, lavamanët e shtëpive, banjat publike, një paqe e vërtetë, po t'i krahasoje me sektorët e stuhishëm të ideologjisë e të artit. Pati, me siguri, nga ata që fshehtazi ia patën zili... Por paqja idilike nuk vazhdoi gjatë. Një i deleguar mbërriti një ditë në N., për të marrë pjesë në mbledhjen e organizatës ku bënte jetën e Partisë ish-padroni i radiotelevizionit. Ç'keni për t'i thënë Partisë në dritën e ngjarjeve të reja që janë zhvilluar kohët e fundit?

Mbledhja, në mbarim të së cilës ai e humbi gjithçka që i kishte mbetur, anëtarësinë e Komitetit Qendror, teserën e Partisë, postin e drejtorit të komunales dhe veturën, nuk vazhdoi gjatë. E kishte ndier vallë veten të lehtësuar, tani që rrokullima ishte kryer më në fund plotësisht, dhe në mëngjesin e ditës tjetër që paraqitur në punë si punëtor i thjeshtë i komunales, veshur me rroba të vjetra dhe me një kapele letre në kokë, nga ato që mbajnë bojaxhijtë për të mos i spërkatur gëlqerja? Askush nuk mund ta dinte, sepse që nga ajo ditë, nuk i foli më asnjeri me gojë. Punonte sipas rastit, herë si bojaxhi, herë si ndihmës në shtrimin e pllakave

majolike në banjat e apartamenteve, me kapelen përherë të spërkatur në kokë, krejtësisht i humbët dhe anonim.

Por, ndonëse me pak vonesë, qetësia do ta kishte kapluar, me siguri, ajo paqe përgjumëse, që sillnin vetveti kovat e bojës, pllakat e bardha majolike dhe sidomos, anonimati shurdhan. Kështu që trokitja ndaj të gdhirë në derën e apartamentit në mëngjesin e arrestimit, duhet të ketë qenë një traumë e vërtetë për të. Ishte e thënë që ta rjetonte ankthin, pikërisht atëherë kur i qe dukur se rrëzim s'kishte më, ngaqë e kishte arritur fundin e greminës.

Pyetja “përse?”, ajo pyetje e mallkuar që e kishte ndjekur hap pas hapi gjatë gjithë rënies së tij, gjer ditën kur i vunë prangat, u duk se do të sqarohej më në fund. Por ajo, jo vetëm nuk u sqarua, po u mjegullua edhe më, gjatë hetimit dhe në vetminë e qelisë. Dhe kështu, gjer në leximin e akt-akuzës, pas së cilës pasuan fjalët e rënda plumb “pesëmbëdhjetë vjet burg”.

Pas kësaj, me siguri e ka ndier më në fund lehtësimin. Ishte lehtësim i vërtetë, i pakërcënueshëm më nga asgjë, me një shije që i afrohej asaj të lumturisë... Sepse gropën e zezë, pa emër, që gjendej diku në një nga minierat e kromit, ai nuk mund ta dintë. Dhe as në çastin kur në gjysmëterr, një dorë e kishte shtyrë atje, ai s'ka patur

kohë të mendonte për asgjë. Rënia kishte qenë kaq e shkurtër, saqë s’mbetej kohë për pyetje, dilema, ose pendim. Me një klithmë ndoshta, ishte shkëputur nga bota, por ajo kishte qenë instiktive, ashtu siç qe instiktive hapja e krahëve të tij, në një përpjekje të verbër për t'u mbajtur në anët e honit, ndërsa binte. Por atë përpëlitje të pashpresë krahësh, kujtim i turbullt që instiki i shpëtimit e kishte nxjerrë nga thellësia e epokave, atëhere kur njerëz e zogj kishin qenë një specie, asnje sy njerëzor nuk e pa. Dhe ishte ndoshta kjo mosparje, që i jepte një përmasë ireale rënies së tij, duke e afruar me rrokullisjen në skëterrë, apo në botën e përposhtme, siç thuhej në përrallën e vjetër.

Po ku do t'i gjenin ata zhgabonjat për t'u kthyer përsëri, dhe nëqoftëse do t'i gjenin, a nuk do të arrinin gjer këtu, të çmishëruar e të kthyer në skelete?

## 12

Orkestra vazhdonte t'i binte fanfarës së gëzueshme. Poshtë tribunës parakalonin minatorët me kaskat plastike, që i bënин të dukeshin më të shkurtër. Ndoshta janë të kromit, mendova. Kaq herë isha përpjekur ta hiqja mendjen prej asaj historie, por ajo s'më ndahej. Me siguri nuk isha i vetmi, që qindra, ndoshta mijëra herë e kisha bërë pyetjen: vërtet ishte nisur ajo letër atëhere nga Lushnja, apo diku, tjetëkund ishte shkruar, dhe ashtu, e humbët, e pavërejtshme, që hedhur një ditë të zakonshme në një nga ato kutitë e postës në qoshet e rrugëve?

Fushata e spastrimeve në ushtri, që shpërtheu fill pas asaj të kulturës, kështu kishte nisur: një lëvizje tankesh përbri një komiteti partie rrethi, thonë se që bërë shkas. Kurse shenjën për fushatën në

ekonomi, ishte një grusht minerali që e dha. Atë grusht minerali me vezullim të dyshimtë, që vërtetonte sabotimin, atë grusht gurësh pra, që ashtu si fustani i gjatë i spikeres, si harta e lëvizjes së tankeve, tërhoqën pas vetes aq arkivolë, dikush arriti ta conte gjer në Komitetin Qendror.

Mjaft, i thashë disa herë vetes. S'doja të kujtoja më asgjë, doja të mbetesha vetëm me trishtimin tim. Po mendja s'më shqitej andej. Nga fustani, nga harta, nga minerali me ndriçim të tjeterllojtë. Po ç'vezullim, veç të botës së përtejme, mund të kishte ai mineral?

Ajo që kishte ndodhur në sallën tonë të mbledhjeve, midis grupimeve të njerëzve dhe fateve të ndryshme, që përsëritur në përmasa të mëdha në shkallë kombëtare. Ushtarakët, që pak më parë, ndërsa bënin sehir sfilitjen e artistëve, ishin tallur me ta, (eh, këta artistët, përherë liberalë, të përkëdhelur, shihini tani si përdridhen), u drodhën si purteka kur rrebeshi pllakosi mbi ta. Më pas, ekonomistët që ishin tallur me vetëbesimin bosh të ushtarakëve, pësuan të njëjtën gjë. Të tjerët që punonin në sektorë të tjerë, e lanë sehirin dhe ironitë dhe, me ankth pritën radhën e goditjes.

Si valët e përsëritura të ethes, vinin rresht psikozat e njohura tashmë: humbja e toruas, ligështimi, përpjekja për të përligjur mungesën e

kurajos, përuljen, lënien në baltë të tjetrit, (diçka kanë bërë, gjersa dënohen kaq rëndë), gjer te valiumet që ishin mbaruar në të gjithë farmacitë, (kërkimi i tyre zgjonte tashmë dyshime), ndarjet e çifteve, depresionet nervore, çmendjet.

Dhe të gjitha këto, të paralajmëruara nga ai horoskop i kobshëm trishenjësh. Nature mort me një fustan të gjatë spikereje, një hartë dhe një grusht minerali. Po në pëlhurën e nature mortit, kishte ende vend: Suzana.

E kërkova prapë me sy midis shtegut të supeve të njerëzve, gjersa e gjeta. Ç'shenjë po sjell? thashë me vete. E yllta, ogurzeza ime!

Sikur e gjithë kjo të kishte ndodhur përpara fushatave të mëdha të spastrimeve, pra, sikur dikujt t'i shkrepente në kokë që në ndryshimin e stilit të veshjes e të sjelljes së një vajze udhëheqësi, të parandiente rrebeshe politike, dhe pas kësaj, të hapte librat e miteve antike, për të gjetur kushedi ç'përngjasime tmerrnjellëse, ky dikush do të ngjante si një i lajthitur, që kishte nevojë për psikiatrin, ose një mendje e çartur histerike, që i kërkonte eksitimet atje ku s'janë dhe s'gjente kënaqësi, veç në tragjedizimin e gjëra.

Por fushatat kishin ndodhur ndërkaq, dhe pavarësisht se prej kohësh ishin fashitur, ashtu si lumenjtë, që pas vërshimit lënë gjurmët e prurjet e

tyre kudo, ashtu tek secili prej nesh, ato kishin depozituar shtresime të tëra. Kështu që mjaftonte vetëm një shenjëz, më parë e pavërejtshme, që ta vinte mendjen dhe zemrën në alarm. Si në një valle të shfrenuar ringjalleshin atëherë gjithë fantazmat që dremitnin, një vëmendje gati bestyde ndaj simboleve, një syçeltësi e sëmurë, dhe pastaj me radhë, dyshimet, parandjenat, ankthet e moçme.

S'ishte pra libri i Grejvsit, as fakti që babai i Suzanës ishte udhëheqës dhe as detajet e tjera të rastësishme, që përftuan në mendjen time analogjinë me dramën antike. Ishte thjesht ajo që kishte ndodhur pak vite më parë prej tiranisë, së cilës nuk mund të shpëtoja dot as unë dhe as askush. Pa ato ngjarje, fjalët e Suzanës për ndërrimin e stilit të jetesës, do të ishin vërtet rutinë banale e korrigjimit të figurës morale të vajzës, në prag të fejesës.

Në tribunë u bë një lëvizje kokash, e shoqëruar nga pëshpëritjet “çfarë, çfarë po ndodh?” U deshën disa çaste që të merrej vesh, se diku nga tribuna D, ose B, po iknin diplomatët e vendeve të Lindjes. Ishte e njëjtë gjë që përsëritez çdo vit, porsa midis manifestuesve shfaqeje pankarta e parë kundër Traktatit të Varshavës. Pas disa minutash, kur në duart e një djali të gjatë u duk pankarta me fjalët “Teori e tri botëve, teori reaksionare”, u larguan edhe kinezët.

Një e qeshur e mbytur përshkoi tribunat.

Pankartat që u bënë shkak për ikjen e diplomatëve të Lindjes, ishin tani poshtë nesh, por unë, me vështrim të ngrirë lexoja të tjera. “Të jetojmë si në rrithim!” “Disiplinë, stërvitje ushtarake, punë prodhuese”.

Me bisht të syrit vështroja të ftuarit që kisha përreth. Kush nga vendasit gjithashtu, duhej të linte tribunën? Sepse secili duhej të kishte kohën e vet të ikjes nga lozha festive...

Ktheva kokën nga tribuna B, ku ma thoshte mendja se duhej t'ishte Th.D., në një kërkim të fundit për ta gjetur me sy. E kishte vallë kohën e zbritjes që andej, apo ora e tij kishte rënë ndërkaq, dhe ai nuk e kishte dëgjuar tingullin e saj?

Po ti, i thashë vetes. Ti që kujton se mund t'i gjykosh të tjerët, a e di orën tënde?

Vezullimi i karficës në flokët e Suzanës, m'i thithi përsëri mendimet drejt saj. Kurrsesi s'mund të ishte një korrigjim i figurës morale, një murgeschëri e shkurtër para fejesës, ose një këshillë e Udhëheqësit kryesor, dhënë babait të saj: (Duhet pakëz modesti, qoftë dhe përkohësisht. Ka shumë thashetheme kohët e fundit për fëmijët tanë.)

Më qartë se Kasandra, unë shihja arkivolet dhe sëpatën e përgjakur të xhelatit mbi altar.

Portreti i Stalinit po afrohej, duke u lëkundur

lehtë, pas ritmit të hapave të atyre që e mbanin. Sytë e tij, me buzëqeshjen e brendshme, të fshehtë, mbushnin horizontin. Përse e flijove tët bir, Jakovin...


Nuk e hiqja dot vështrimin nga pëlhura e madhe valëvitëse. Tët bir, Jakovin, përsërita, ndjesë pastë!

U habita se nga më erdhi kjo shprehje e vjetër, që s'përdorej më prej brezit tonë. Dhjetëra shprehje si ajo, zbutëse, përdëllyese, që të kuqtonin përkohshmérinë e jetës, ishin dëbuar ngajeta e përditshme. Ashtu siç ishin dëbuar këmbanat, lutjet, qirinjtë dhe bashkë me to, mëshira, pendesa, o Perëndi, kishin ikur të gjitha, për t’ia bërë më të lehtë triumfin krimtit.

Jakovin, tët bir, ndjesë pastë, pse e dhé... Mareshallët vinin përditë që të të mbushnin mendjen. Ndërrimet e robërve ishin të zakonshme në luftë, e aq më tepër, për djalin tënd. Për qetësinë tënde shpirtërore në radhë të parë, për të mirën e përgjithshme. Por ti the: jo dhe jo! Ç’bluaje ndër mend, o sfinks, kur u përgjigje ashtu?

Portreti i babait të Suzanës, i dhjeti ndoshta gjer tanë, u shfaq jo shumë larg atij të Stalinit. Ti s’mund ta dish kurrë arsyen e ndryshimit të Suzanës, më thoshte vështrimi i tij. Ti mund të depërtosh në seksin e saj, madje në zemrën e saj, por s’mund ta kuptosh asnjëherë atë, që as ajo vetë s’e di!

Rreshtat e ngjeshur të parakaluesve nuk kishin fund. Mungonte vetëm portreti i Agamemnonit. Anëtarit të Byrosë Politike, shokut Agamemnon Atridit. Ai, mësuesi i madh i çdo flüjimtari të ardhshëm, themeluesi, klasiku, e dinte padyshim, më mirë se kushdo këtë punë.



## 13

Ndihej që parakalimi po i afrohej fundit. Sipas traditës, e mbyllnin institucionet kulturore... Opera e baleti, kinostudioja, universiteti i Tiranës. U fsheha përgjysëm, kur poshtë tribunës pashë shokët e mi të radiotelevizionit. Pastaj me radhë personelin teknik, grimierët, spikerët e mbrëmjes, me fustanet e gjata si vestalet...

Disa minuta më vonë, gjithçka kishte mbaruar. Ndërsa kuadratet e fundit të manifestuesve largoheshin me hap të lëshuar, pasi kishin lëshuar brohoritjen e fundit drejt sheshit “Skënderbe”, tribunat nisen të zbrazeshin, më shpejt seç pritej. Të ftuarit po zbrisnin shkallët, me atë shprehje shpërqendrimi, që pason zakonisht darkat e shumëpritura, gjyqet, apo aktin e dashurisë. Dy-tri herë e gjeta me sy Suzanën, dhe prapë e humba.

Shumë shpejt u gjenda në bulevard, midis rrjedhës së njerëzve që iknin përtueshëm nën diellin që befas, të dukej më i nxehëtë. Copëra kurorash e lulesh artificiale të prishura ishin hedhur kudo. Tollumbace të plasura, të shkelura me këmbë, dergjeshin nëpër pluhur. Portretet e mëdhenj, për shkak të mbajtjes pa kujdes, anoheshin sa andej-këndej, sytë iu vështronin pjerrtaz, ose më keq, në drejtim të tokës. Te gjithkush ndihej djersitja, lodhja dhe një shkrehje e përgjithshme.

Dymijë e tetëqind vjet më parë, ushtarët grekë ktheheshin, me siguri kështu, nga vendi i flijimit të Ifigjenisë. Me fytyra të verdha nga pamja e gjakut në altar dhe, me zbrazëtinë që dukej se s'do të riparohej kurrë brenda tyre. Nuk flisnin, madje dhe mendimet i kishin të rralla, të përsëritura lodhshëm. Ushtarit Teukër, që kishte vendosur të dezertonte qysh në ndeshjen e parë, i dukej tani e largët kjo ide. Dhe po aq i pakuptimitë i dukej ushtarit tjetër, Idomeneut, vendimi për t'i kthyer fjalë komandantit në rastin e parë të brutalitetit të tij. Kurse Astianaksit, i cili kishte vendosur të ikte pa leje te e fejuara, vendim që, sa më shumë e digjte malli për të, aq më i lehtë dukej, tani i ngjante i pamundur. Gjithçka e lehtë, gazmore, që do të shpërndante disi mërzinë e luftës: shakatë, thyerjet e disiplinës, mbrëmjet e gëzueshme në bordel, po luhatej

trembshëm tani. Përderisa shefi i madh, Agamemnoni, kishte fliuar vajzën e vet, asnje mëshirë s'do të kishte për askënd. Sëpata qe përgjakur tashmë....

Dhe befas, m'u duk se e zbulova enigmën. Ndjesia e zbulimit ishte e tillë, saqë më bëri të mbaj hapat dhe të mbyll sytë, thua se pamja e botës reale do të ma mjegullonte prapë atë, që mezi po më qartësohej... Qe fliuar Jakovi, ndjesë pastë, jo për të patur fatin e çdo ushtari tjeter rus, siç kishte deklaruar diktatori, por për t'i dhënë të drejtën diktatorit, të kërkonte vdekjen e cilitdo. Ashtu si Ifigjenia, që i dha Agamemnonit të drejtën për kasaphanën...

S'ishte, as bindja se flijimi do të shtronte erërat që pengonin flotën, as një parim moral për barazinë e djemve të Rusisë. Ishte thjesht një përllogaritje cinike tiranësh.

E ti, unë e di ç'kërkon ti, me anë të Suzanës... Sëpatën s'do ta spërkatësh me gjak, e di, por edhe ashtu ndoshta, e bardhë, ajo mund të godasë hatashëm.

E kisha gjetur ndoshta qysh më parë, tinëzisht i isha afruar të vërtetës, qysh pas çastit që Suzana më foli për vendimin e saj. Ajo që kërkonte babai i saj, dukej më pak, por ishte më shumë. Megjithëse pa gjak, ishte e denjë të krahasohej me flijimin më

të përgjakshëm. Ishte më e mynxyrshme padyshim, se gjithë arkivolet që ndollën letra nga Lushnja, grushti vezullues i mineralit dhe ajo harta fatale... Mijëra mbasdite të mbytura jete njerëzore, mos ishin më pak se një pirg kufomash? Dhe dhjetëra mbarime vjeshte të çnatyruara; dhe bisedat pasdarke të asfiksuarë si me gaz helmues, dhe dështime borërash, aromash të dimrit dhe të prishur stolat e ngjerë në blu ndanë pishinës, kafenetë studenteske plot zhurmë, tangot, orët prej bronzi që lajmërojnë mesnatën në korridore apartamentesh, krehja e flokëve përpëra pasqyrave, dhe bizhutë, pelicet, pudra e lodhur...

Sepse tharjen e mëtejshme të jetës parandillte Suzana. Të asaj jete që, si kaktusi në shkretëtirë, me vështirësi e kishte ruajtur lëngun e fundit.

Ti paske qenë helm dhe murtajë bashkë, klitha me vete. Ishte vazhdimi i fushatave që ndollën letra nga Lushnja, minerali dhe harta. Dhe, jo vetëm që asnje Kalkant s'e kishte dhënë këshillën, por as babai i Suzanës s'e kishte menduar vetë. Tjetërkush, Udhëheqësi i madh, ai që po e caktonte atë si pasardhës, ia kishte kërkuar me siguri. (Eshtë zemërbutë babai, më kishte thënë Suzana, s'është i lindur për egërsi).

E kishte kuptuar, ndoshta, Udhëheqësi natyrën e tij dhe në njëfarë mënyre, ia kishte thënë: zgjidh

njëren nga të dy sëpatat. Nëqoftëse s'je i aftë të përdorësh të përgjakurën, merr të bardhën! Dhe qysh tani, sa jam unë gjallë, në sytë e mi, bëj provën! Godit! E bardha, po të dish ta përdorësh, është ndoshta më e tmerrshme se tjetra.

Ja pra, këtë sëpatë të dytë paralajmëronte Suzana. I lodhur siç qe prej tjetrës, së përgjakurës, vendi po i nënshtrohej një goditjeje të re.

Ruaje, Zot, këtë vend nga çjetëzimi, klitha përsëri. Mbroje nga shkrumbimi i mëtejshëm! Se atë që nuk ia bënë dot vapa dhe pluhuri aziatik, po ia bën vetvetes.

Pankartat mbi supet e manifestuesve të lodhur, lëkundeshin aty-këtu. “Të revolucionalizojmë më tej gjithë jetën!” “Kalitje, punë në prodhim, stërvitje”.

Po këto i kam patur në sy gjatë gjithë manifestimit, mendova. Dhe gjithë vitet e fundit kanë qenë pérherë aty. Ishin ato që duhej të kishin zëvendësuar dihajten e dashurisë, qelqërinë e trishtë të muzgut, dhe bizhutë dhe muzikën e vallëzimit, dhe dantellat rrëth ijeve të grave. Puna në prodhim, stërvitja ushtarake, studimi i veprave të Udhëheqësit... Dhe meqenëse nuk i kishin zëvendësuar dot, po niste fushata e madhe, e re.

“Të punojmë, të jetojmë, të mendojmë si revolucionarë!” “Të revolucionarizojmë gjithçka!”...

Sa vjet shterpësie të tillë do të duheshin për ta kthyer jetën në djerrinë? Dhe e gjithë kjo, për të vetmen arsyen, se kështu e fishkur, e tharë, jeta sundohej më lehtë.

Tëmthat më rrini si çekan, megjithatë, nuk e ndërprisa dot ritmin kaotik të menduarit. Si mund të revolucionarizohej, o Perëndi, seksi i femrës?! Sepse për ta nisur punën nga themeli, që andej duhej filluar, nga burimi i jetës... Të modifikohej pamja e tij, delta e errët sipër, vija e lagësht e buzëve... Të riedukohej, duke i hequr mbeturinat e së shkuarës, orgazmën, kujtimet mijëvjeçare të kënaqësisë.

Do të shqyhesha gazit, sikur të mos isha i brengosur.

“Trekëndëshi revolucionar: mësim, punë prodhuese, stërvitje ushtarake”. Po trekëndëshi i zi i seksit, ç’do të bëhej? E plasaritur delta e tharë, e mjerë, me ca fije bari të rralla stepe sipër.

Asnjëherë dendësia e parrullave s’kishte qenë e tillë. Ja dhe ajo, e famshmja, e barit. “Ne do të mbrojmë parimet e marksizëm-leninizmit, dhe sikur të detyrohemë të hamë vetëm bar”.

I verbër, i thirra vetes. Ti e kishe të vërtetë përpara syve dhe i kërkoje sinjalët tri mijë vjet larg. Shfletoje libra, mundoje trurin, për atë që ishte e qartë, edhe pa to.

E çfarë pastaj, thashë me vete paspak. Ç'gabim kisha bërë? Sinjali që më kishte dhënë Suzana ishte i saktë dhe kjo ishte kryesorja. Kurse Ifigjenia e përgjakur, nuk kundërshtonte asgjë me dëshminë e saj, përkundrazi!

Të gjitha po ndodhnin si dikur, ndoshta më llahtarshëm. Në brigjet e Aulidës, anijet greke po nisen njëra pas tjetrës, drejt Trojës. Shkëputen me forcë spirancat prej gurëve të mëdhenj, që bien shkumëzueshëm në ujë. Njëra pas tjetrës, këputen spirancat, si shpresat e fundit.

Fushata e Trojës ka filluar.

Asgjë nuk e pengon më tharjen e jetës:

Tiranë 1985